



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË DIBËR

Peshkopi më 18.12.2020.

K Ë R K E S Ë

PËR DËRGIMIN NË GJYQ TË ÇËSHTJES PENALE NR.385/2019

GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR

DIBËR

I nderuar z.Gjyqtar i seances paraprake !

Në përfundim të hetimeve paraprake të çështjes penale nr.385, datë 04.09.2019, të regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, kundër të pandehurve:

-Robert Aga, atësia Nazif, mëmësia Luftime, datëlindja 2809.1963, vendlindja fshati Grezhdan, Njësia Administrative Mqellarë, bashkia Dibër, vendbanimi Njësia Administrative nr.7, rruga “Zografët”, banesë private nr.47, Tiranë, arsimi i lartë, gjendja civile i martuar, gjendja gjyqësore i pa dënuar më parë, shtetësia shqiptare, identifikuar nga sistemi TIMS me nr.personal G30928037A, përdorues i nr.celular 068 20 44 141, i hetuar në gjendje të lirë, (pa masë sigurimi), i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal.

-Drini Gjeci, atësia Ramazan, mëmësia Safie, datëlindja 30.03.1969, vendlindja fshati Brezhdan, Njësia Administrative Tomin, bashkia Dibër, vendbanimi qyteti Peshkopi, bashkia Dibër, shtetësia shqiptare, arsimi i lartë, gjendja civile i martuar, gjendja gjyqësore i padënuar më parë, identifikuar me dokumentin kartë identiteti nr.028833411, datë 16.04.2010, nr.personal G90330231G, përdorues i nr.celular 068 23 50 139, i hetuar në gjendje të lirë (pa masë sigurimi), i akuzuar për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer më shumë se një herë, parashikuar nga nenet 248 dhe 329/3, të Kodit Penal.

-Hasan Hoti, atësia Arif, mëmësia Nuriye, datëlindja 13.07.1965, vendlindja fshati Borie Lurë, Njësia Administrative Lurë, bashkia Dibër, vendbanimi fshati Borie Lurë, Njësia Administrative Lurë, bashkia Dibër, arsimi i lartë, gjendja civile i martuar, gjendja gjyqësore

i padënuar më parë, shtetësia shqiptare, identifikuar nga sistemi TIMS me nr.personal **G50713005Ë**, përdorues i nr.celular 068 21 87 497, i hetuar në gjendje të lirë, (pa masë sigurimi), i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje*”, kryer më shumë se një herë, parashikuar nga neni 329/3 i Kodit Penal.

-**Nuri Meda**, atësia Xhabir, mëmësia Shame, datëlindja 30.07.1958, vendlindja fshati Brezhdan, Njësia Administrative Tomin, bashkia Dibër, vendbanimi lagjia “*Kamen*”, qyteti Peshkopi, bashkia Dibër, arsimi i lartë ekonomi, gjendja civile i martuar, gjendja gjyqësore i padënuar më parë, shtetësia shqiptare, identifikuar nga sistemi TIMS me nr.personal F80730082D, posedues i nr.celular 068 34 96 073, i hetuar në gjendje të lirë (pa masë sigurimi), i akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal.

Nga hetimet e zhvilluara ka rezultuar se:

I. DEPOZITIMI I KALLËZIMIT PENAL DHE PRETENDIMET KALLËZUESIT

Me datë 01.09.2016, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, është depozituar një kallëzim penal, me shkrim, nga:

Kallëzuesi: *Edi Paloka, Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Shqipërisë.*

Me objekt: *Kallëzimin e veprave penale: “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 328, 329, 333/a dhe 334, të Kodit Penal.*

Kundër: *Grupit Kriminal të Partisë Socialiste në bashkinë Dibër, të angazhuar në kryerjen e veprave penale të blerjes së votës dhe kanosjes së votuesve, sipas objektit të këtij kallëzimi.*

Baza ligjore: *Nenet 280 dhe 283, të Kodit të Procedurës Penale dhe nenet 25, 328, 329, 333/a dhe 334, të Kodit Penal.*

Në themel të këtij kallëzimi penal, është pretenduar se në territorin e bashkisë Dibër, një grup personash, të organizuar nga Partia Socialiste Dibër, në formën e grupit të strukturuar kriminal, nëpërmjet dhënies së shpërblimeve dhe premtimeve, ushtrimit të presionit dhe dhunës ndaj qytetarëve si dhe formave të tjera kriminale, synojnë të deformojnë vullnetin e zgjedhësve dhe rezultatin e zgjedhjeve, në favor të kandidatit që garon nën siglën e Partisë Socialiste, në zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Dibër, që do zhvilloheshin me datë 11 shtator 2016.

Sipas kallëzimit penal, është pretenduar se, grupi kriminal rezulton të jetë aktiv dhe vepron në zona të caktuara të territorit të bashkisë Dibër, prej të paktën 10 ditëve dhe personat e përfshirë në kryerjen e veprave penale të blerjes së votave dhe kanosjes së votuesve janë:

1-Dionis Imeraj, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Dibër, i cili sipas kallëzimit, është personi i ngarkuar me sigurimin e fondeve financiare për blerjen e votave, si dhe kryen veprimtarinë kriminale të shpërndarjes së parave në zonat e Sllovës dhe Kala e Dodës, në këmbim të votave në favor të kandidatit Muharrem Rama.

2-Afrim Mikli, Kryetar i Partisë Socialiste Dibër, bashkëpunëtor i ngushtë i shtetasit Ymer Lala, të cilët sipas kallëzimit, së bashku apo veç e veç, kryejnë veprimtarinë kriminale të shpërndarjes së parave në këmbim të votës, në zonën Muhurr dhe Selishtë.

3-Arben Keshi, Drejtor i Qendrës së Mbyllur për të Huajt e Parregullt, në Republikën e Shqipërisë, i cili sipas kallëzimit, kryen veprimtarinë kriminale të shpërndarjes së parave në këmbim të votave, në zonën e Maqellarës.

4-Agron Malaj, Drejtor Rajonal i OSHEE për Veriun, i cili sipas kallëzimit, kryen veprimtarinë kriminale të shpërndarjes së parave në këmbim të votës, në zonën e qytetit Peshkopi.

5-Ylli Mikli, Administrator i Njesisë Administrative Muhurr, i cili sipas kallëzimit, kryen veprimtarinë kriminale të shpërndarjes së parave në këmbim të votës, në zonën e Muhurrit.

6-Spartak Koltraka, i cili sipas kallëzimit, kryen veprimtarinë kriminale të shpërndarjes së parave në këmbim të votes, në zonën e Kastriotit.

7-Nuri Meda, cili sipas kallëzimit, kryen veprimtarinë kriminale të shpërndarjes së parave në këmbim të votes, në zona të caktuara të bashkisë Dibër.

8-Qamil Lata, eksponent i Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU), i cili sipas kallëzimit, kryen veprimtarinë kriminale të shpërndarjes së parave në këmbim të votes, në zonën e Kalasë së Dodës.

9-Jetmir Lleshi, me profesion mjek, me detyrë anëtar i Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Aftësisë së Kufizuar (KEMP), i cili sipas kallëzimit, kryen veprimtarinë kriminale të kanosjes së zgjedhësve, kryesisht të administratës publike.

10-Drini Gjeci, Drejtor, i Drejtorisë Rajonale Arsimore Dibër, i cili sipas kallëzimit, kryen veprimtarinë kriminale të kanosjes së zgjedhësve, kryesisht të administratës publike.

11-Sonila Braha, Drejtore, e Drejtorisë së Shërbimit Social Dibër, e cila sipas kallëzimit, kryen veprimtarinë kriminale të kanosjes së zgjedhësve, kryesisht të administratës publike.

12-Robert Aga, Shef i Komisarariatit të Policisë Dibër, i cili sipas kallëzimit, kryen veprimtarinë kriminale të kanosjes së zgjedhësve, kryesisht të administratës publike.

Në vijim, kallëzuesi Edi Paloka, në datat **02.09.2016** dhe **08.09.2016**, ka depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, edhe dy kallëzime të tjera penale me shkrim, (**shtesë të kallëzimit të datës 01.09.2016**), në të cilat është pretenduar se nga të dhënat e mbledhura, si pjesë e grupit kriminal të krijuar për blerjen e votave, janë identifikuar edhe persona të tjerë dhe konkretisht:

13-Bekim Krashi, i cili sipas kallëzimit, kryen veprimtarinë kriminale të shpërndarjes së parave në këmbim të votës, në zonën e Arrasit.

14-Shaban Uklala, i cili sipas kallëzimit, kryen veprimtarinë kriminale të shpërndarjes së parave në këmbim të votës, në zonën e Reçit.

15-Abaz Kaca, i cili sipas kallëzimit, kryen veprimtarinë kriminale të shpërndarjes së parave në këmbim të votës, në zonën e Zall Dardhës.

16-Fatbardh Lala, i cili sipas kallëzimit, kryen veprimtarinë kriminale të shpërndarjes së parave në këmbim të votës, në zona të ndryshme të bashkisë Dibër.

17-Hasan Hoti, i cili sipas kallëzimit, kryen veprimtarinë kriminale të shpërndarjes së parave në këmbim të votës, në zona të ndryshme të bashkisë Dibër.

18-Dik Spata, i cili sipas kallëzimit, kryen veprimtarinë kriminale të shpërndarjes së parave në këmbim të votës, në zona të ndryshme të bashkisë Dibër.

19-Damian Gjikhuri, me detyrë Ministër i Energjitikës, i cili sipas kallëzimit penal, identifikohet me cilësinë e organizatorit, duke dhënë udhëzime mbi skemën e shpërndarjes së parave në këmbim të votës.

II. REGJISTRIMI I PROCEDIMIT, VENDIMARRJET E ORGANIT TË PROKURORISË

Bazuar në materialin kallëzues të depozituar nga shtetasi Edi Paloka, Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Shqipërisë si dhe duke u mbështetur edhe në disa njoftime të publikuara në mediat online, (*lapsi.al dhe shqiptarja.com*), ku janë denoncuar raste të shpërndarjes së parave në këmbim të votës dhe kanosje apo ushtrim dhune ndaj zgjedhësve, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, **me datë 09.09.2016**, ka regjistruar procedimin penal **nr.184, të vitit 2016**, për veprat penale “Grupi i strukturuar kriminal”, “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve” dhe “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, parashikuar nga nenet 333/a, 328 dhe 329, të Kodit Penal, **pa ia atribuuar kryerjen e tyre ndonjë personi të caktuar.**

Pas kryerjes së një sërë veprimesh hetimore, duke përfshirë këtu edhe transkriptimin e një numri të konsiderueshëm bisedash telefonike të përfuturara nga përgjimi i numrave celular të personave të kallëzuar, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, **me datë 19.09.2018**, ka urdhëruar regjistrimin në regjistrin e njoftimit të veprave penale, për procedimin penal nr.184, të vitit 2016, emrat e personave nën hetim dhe konkretisht:

1-Imer Lala, aktualisht me emrin Korab Lala, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje” dhe “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 328, 329 dhe 333/a, të Kodit Penal.

2-Robert Aga, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje” dhe “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 248, 328, 329 dhe 333/a, të Kodit Penal.

3-Dionis Imeraj, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje” dhe “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 248, 328, 329 dhe 333/a, të Kodit Penal.

4-Afrim Mikli, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”

dhe “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 248, 328, 329 dhe 333/a, të Kodit Penal.

5-Drini Gjeci, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje” dhe “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 248, 328, 329 dhe 333/a, të Kodit Penal.

6-Arben Keshi, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje” dhe “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 328, 329 dhe 333/a, të Kodit Penal.

7-Hasan Hoti, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje” dhe “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 328, 329 dhe 333/a, të Kodit Penal.

Në vijim të hetimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, duke analizuar rolin e secilit prej të dyshuarve, në raport me vlerën provuese të burimeve të provave të grumbulluara, ka konkluduar se veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve” dhe “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, të parashikuara nga nenet 248, 328 dhe 329, të Kodit Penal, të atribuara personave nën hetim, nuk janë kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, sikurse është ajo e “**grupit të strukturuar kriminal**”, të parashikuar në nenin 333/a, të Kodit Penal, por këto vepra janë kryer në formën e “**bashkëpunimit të thjeshtë**”, e parashikuar në nenin 25, të Kodit Penal.

Me këtë arsyetim, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, me urdhër të datës 12.07.2019, ka urdhëruar ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale të atribuuar personave nën hetim, nga forma e veçantë e bashkëpunimit, sikurse është “**Grupi i strukturuar kriminal**”, parashikuar nga neni 333/a, i Kodit Penal, në formën e “**bashkëpunimit të thjeshtë**”, parashikuar nga neni 25, i Kodit Penal, ku sipas ndryshimeve të bëra me këtë urdhër, personat nën hetim, në këtë moment procedural, janë dyshuar për këto vepra penale:

1-Imer Lala, (aktualisht me emrin Korab Lala), i dyshuar tashmë për kryerjen e veprave penale “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve” dhe “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, të kryera në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328, 329 dhe 25, të Kodit Penal.

2-Robert Aga, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve” dhe “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, të kryera në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248, 328, 329 dhe 25, të Kodit Penal.

3-Dionis Imeraj, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve” dhe “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, të kryera në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248, 328, 329 dhe 25, të Kodit Penal.

4-Afrim Mikli, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve” dhe “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në

zgjedhje”, të kryera në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248, 328, 329 dhe 25, të Kodit Penal.

5-Drini Gjeci, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve” dhe “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, të kryera në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248, 328, 329 dhe 25, të Kodit Penal.

6-Arben Keshi, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës”, “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve” dhe “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, të kryera në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248, 328, 329 dhe 25, të Kodit Penal.

7-Hasan Hoti, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve” dhe “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, të kryera në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328, 329 dhe 25, të Kodit Penal.

Pas ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale, nga “Grup i strukturuar kriminal”, në “bashkëpunim i thjeshtë”, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, me **vendimin e datës 15.07.2019**, ka vendosur “Shpalljen e moskompetencës lëndore për hetimin e mëtejshëm të procedimit penal nr.184, të vitit 2016 dhe kalimin e akteve për kompetencë lëndore (dhe tokësore njëkohësisht) në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër”.

Pas adminstrimit të akteve të procedimit penal nr.184, të vitit 2016, të cilat janë përcjellë me **shkresën nr.116, datë 18.07.2019**, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, (**hyrë në Prokurorinë Dibër me datë 18.07.2019**), Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, duke mos u pajtuar me vendimin e Prokurorisë së Krimeve të Rënda “Për shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve për hetim Prokurorisë Dibër”, me aktin e datës **21.07.2019**, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme Tiranë, “Kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës për këtë procedim penal”, përcjellë me shkresën **nr.1398/1 prot, datë 21.07.2019**, duke i kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm, caktimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, si prokurori kompetente për ushtrimin e ndjekjes penale në procedimin penal nr.184, të vitit 2016.

Në themel të kërkesës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, ka argumentuar se veprat penale janë kryer në formën e grupit të strukturuar kriminal dhe jo në formën e bashkëpunimit të thjeshtë dhe për këtë shkak kompetenca i takon Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

Prokurori i Përgjithshëm, me vendim **nr.138, datë 31.07.2019**, “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe caktimin e kompetencës”, ka vendosur: “Caktimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, si prokurori kompetente për hetimin paraprak të procedimit penal nr.184/2016 dhe dërgimin e akteve të këtij procedimi penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, për vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve”.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, mbi bazën e vendimit nr.138, datë 31.07.2019, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe caktimin e kompetencës”, dhe akteve të procedimit penal nr.184/2016, të cilat janë përcjellë me shkresën nr.1985/1 prot, datë 05.08.2019, të Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë, (hyrë dhe regjistruar në Prokurorinë Dibër me nr.1567 prot, datë 07.08.2019), ka regjistruar fillimisht kallëzimin penal nr.610, datë 13.08.2019 dhe më pas procedimin penal nr.385, datë 04.09.2019, në ngarkim të shtetasve nën hetim:

1-Korab Lala, (i njohur ndryshe edhe si Imer Lala), i dyshuar për kryerjen e veprave penale:

- “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.
- “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 329/3, i Kodit Penal.

2-Robert Aga, i dyshuar për kryerjen e veprave penale:

- “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal.
- “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.
- “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 329/3, i Kodit Penal.

3-Dionis Imeraj, i dyshuar për kryerjen e veprave penale:

- “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal.
- “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.
- “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 329/3, i Kodit Penal.

4-Afrim Mikli, i dyshuar për kryerjen e veprave penale:

- “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal.
- “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.
- “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 329/3, i Kodit Penal.

5-Drini Gjeci, i dyshuar për kryerjen e veprave penale:

- “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal.
- “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.
- “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 329/3, i Kodit Penal.

6-Arben Keshi, i dyshuar për kryerjen e veprave penale:

- “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal.
- “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.
- “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 329/3, i Kodit Penal.

7-Hasan Hoti, i dyshuar për kryerjen e veprave penale:

- “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.
- “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 329/3, i Kodit Penal.

Në vijim të hetimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, me urdhrin e datës **13.01.2020**, ka ndryshuar cilësimin juridik, sa i përket formës së kryerjes së veprave penale të atribuuara personave nën hetim, nga “**bashkëpunim i thjeshtë**”, parashikuar nga neni 25, i Kodit Penal, në “**Grup i strukturuar kriminal**”, parashikuar nga neni 333/a, i Kodit Penal, ku sipas ndryshimeve të bëra me këtë urdhër, personat nën hetim, në këtë moment procedural janë dyshuar për këto vepra penale:

1-Korab Lala, (i njohur ndryshe edhe si Imer Lala), i dyshuar për kryerjen e veprave penale:

- “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.
- “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 329/3, i Kodit Penal.
- “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a, i Kodit Penal.

2-Robert Aga, i dyshuar për kryerjen e veprave penale:

- “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal.
- “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.
- “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 329/3, i Kodit Penal.
- “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a, i Kodit Penal.

3-Dionis Imeraj, i dyshuar për kryerjen e veprave penale:

- “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal.
- “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.
- “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 329/3, i Kodit Penal.
- “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a, i Kodit Penal.

4-Afrim Mikli, i dyshuar për kryerjen e veprave penale:

- “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal.
- “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.
- “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 329/3, i Kodit Penal.
- “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a, i Kodit Penal.

5-Drini Gjeci, i dyshuar për kryerjen e veprave penale:

- “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal.
- “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.
- “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 329/3, i Kodit Penal.
- “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a, i Kodit Penal.

6-Arben Keshi, i dyshuar për kryerjen e veprave penale:

- “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal.
- “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.
- “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 329/3, i Kodit Penal.
- “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a, i Kodit Penal.

7-Hasan Hoti, i dyshuar për kryerjen e veprave penale:

- “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.
- “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 329/3, i Kodit Penal.
- “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a, i Kodit Penal.

Po me këtë urdhër, Prokuroria pranë gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, ka regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale edhe një tjetër shtetas nën hetim dhe konkretisht:

8-Bekim Krashi, i dyshuar edhe ky për kryerjen e veprave penale:

- “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal.
- “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.
- “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 329/3, i Kodit Penal.
- “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a, i Kodit Penal.

Pas atribuimit personave nën hetim, të veprës penale “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a, i Kodit Penal, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, me **vendimin e datës 22.01.2020**, ka vendosur: “Shpalljen e moskompetencës lëndore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Dibër për hetimin e procedimit penal nr.385, të vitit 2019 dhe kalimin e akteve për kompetencë lëndore pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Tiranë”. Vendimi për shpalljen e moskompetencës bashkë me aktet e dosjes penale nr.385, të vitit 2019, i janë përcjellë Prokurorisë së Posaçme, me **shkresën nr.111 prot, datë 22.01.2020**, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër.

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Tiranë, pasi ka marrë në shyrzim vendimin e Prokurorisë Dibër, datë 22.01.2020 “Për shpalljen e moskompetencës lëndore” si dhe aktet e procedimit penal nr.385, të vitit 2019, **me vendimin e datës 27.01.2020**, ka vendosur: “Mospranimin për kompetencë të akteve të procedimit penal nr.385, të vitit 2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër dhe ridërgimin e tyre për kompetencë lëndore dhe tokësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër”.

Në vendimin e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Tiranë, për ridërgimin e akteve për kompetencë lëndore dhe tokësore në Prokurorinë Dibër, është arsyetuar se: vendimi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, datë 22.01.2020, “Për shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve për kompetencë Prokurorisë së Posaçme”, është një vendim i marrë tërësisht në kundërshtim me kërkesat e neneve 24, 28/1/2, 84 dhe 278/2, të Kodit të Procedurës Penale, për faktin se elementët e “grupit të strukturuar kriminal” janë vlerësuar më parë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda si dhe nga Prokurori i Përgjithshëm (të cilët kanë argumentuar se nuk kemi të bëjmë me grup të strukturuar kriminal por me bashkëpunim të thjeshtë) dhe që prej atij momenti dhe në vazhdim, jo vetëm që nuk janë kryer veprime hetimore duke marrë në konsideratë këto vendimmarrje me qëllim që të mbledheshin prova të tjera shtesë për personat nën hetim, por për më tepër, nuk është kryer asnjë veprim tjetër hetimor.

Gjithashtu, Prokuroria e Posaçme ka arsyetuar se në bazë të nenit 75/a, të Kodit Procedurës Penale, kompetenca lëndore për ushtrimin e ndjekjes penale për bashkëpunimin e posaçëm, në formën e “grupit të strukturuar kriminal”, i përket Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Tiranë dhe për rrjedhojë, vlerësimi i elementëve të kësaj forme të veçantë bashkëpunimi, është në kompetencën e Prokurorisë së Posaçme.

Për këtë shkak, bazuar në kërkesat e nenit 128/a, paragrafi (1), gërma (b), të Kodit të Procedurës Penale, për arsye të mosrespektimit të dispozitave që lidhen me të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale në këtë rast, urdhri i datës 13.01.2020, i prokurorëve të Prokurorisë Dibër, “Për pasqyrimin e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale në regjistrin e njoftimit të veprave penale dhe regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, është një akt procedural “**absolutisht i pavlefshëm**” dhe **cilësohet si i tillë nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme**.

Pas kësaj vendimmarrje, Prokuroria Kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar, Tiranë, me shkresën **nr.34/1 prot, datë 27.01.2020**, ka ridërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, aktet e procedimit penal nr.385, të vitit 2019, të cilat janë bërë hyrje në Prokurorinë Dibër duke u regjistruar me **nr.111/1 prot, datë 28.01.2020**.

Pas administrimit të akteve në Prokurorinë Dibër, me vendimin e Drejtuesit të Prokurorisë Dibër, datë **03.02.2020**, është vendosur: *“Pranimi i kërkesës së prokurores Belina Kryemadhi (Zeneli), për heqjen dorë nga hetimi i mëtejshëm i procedimit penal nr.385, të vitit 2019, si dhe zëvendësimi i prokurorëve Belina Kryemadhi (Zeneli) dhe Rifat Kojku, me prokurorin Urim Buci, i cili është ngarkuar për vazhdimin e hetimit të mëtejshëm të këtij procedimi penal.*

Pas këtij momenti, hetimi i këtij procedimi penal është vijuar nga prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, Urim Buci, i cili me administrimin e dosjes penale, me urdhrin e datës **03.02.2020**, *“Për delegimin dhe kryerjen e veprimeve hetimore”*, ka urdhëruar policinë gjyqësore të seksionit të Prokurorisë Dibër, për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore, në funksion të provimit të fakteve dhe rrethanave të kryerjes së veprave penale të dyshuara dhe bazuar në këtë urdhër nga policia gjyqësore janë kryer një sërë veprimesh hetimore si, transkriptimi dhe analiza e komunikimeve telefonike të përgjuara si dhe verifikime të tjera.

Në fazën e përfundimt të hetimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, me **urdhrin e datës 24.11.2020**, ka urdhëruar ndryshimin e cilësimit juridik të veprave penale të atribuuara personave nën hetim, ku sipas ndryshimeve të bëra me këtë urdhër, përfundimisht personat nën hetim janë dyshuar për këto vepra penale:

1-Korab Lala, (i njohur ndryshe edhe si Imer Lala), përfundimisht është dyshuar për kryerjen e veprës penale “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.

2-Robert Aga, përfundimisht është dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal.

3-Dionis Imeraj, përfundimisht është dyshuar për kryerjen e veprës penale “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.

4-Afrim Mikli, përfundimisht është dyshuar për kryerjen e veprës penale “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.

5-Drini Gjeci, përfundimisht është dyshuar për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal, “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer më shumë se një herë, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal dhe “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 329/3, i Kodit Penal.

6-Arben Keshi, përfundimisht është dyshuar për kryerjen e veprës penale “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.

7-Hasan Hoti, përfundimisht është dyshuar për kryerjen e veprave penale “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal dhe “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer më shumë se një herë, parashikuar nga neni 329/3, i Kodit Penal.

8-Bekim Krashi, përfundimisht është dyshuar për kryerjen e veprës penale “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal.

Po me këtë urdhër, Prokuroria pranë gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, ka regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale edhe një tjetër shtetas nën hetim dhe konkretisht:

9-Nuri Meda, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal.

Në përfundim të kryerjes së veprimeve hetimore e procedurale organi i prokurorisë ka konkluduar se fakti penal i hetuar, plotëson elementët e veprave penale “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, kryer në bashkëpunim, “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer më shumë se një herë dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, 329/3 dhe 248, të Kodit Penal, **(në fuqi në vitin 2016)**.

• Në lidhje me veprën penale “**Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve**”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 328/1 dhe 25, të Kodit Penal, **(në fuqi në vitin 2016)**, organi i Prokurorisë ka konkluduar se kjo vepër është kryer nga personat nën hetim **1-Korab Lala**, (i njohur ndryshe edhe si **Imer Lala**), **2-Robert Aga**, **3-Afrim Mikli**, **4-Drini Gjeci**, **5-Arben Keshi**, **6-Hasan Hoti**, **7-Bekim Krashi** dhe **8-Nuri Meda** dhe përveç tyre, edhe nga shtetasit **9-Fatbardh Lala**, **10-Ylli Mikli** dhe **11-Dik Spata**, të cilët gjatë hetimit të këtij procedimi penal kanë patur statusin e të kallëzuarit, por pavarësisht këtij fakti, ndjekja penale ndaj tyre nuk ka vazhduar, për shkakun se kundërvajtja penale e parashikuar nga neni 328/1 i Kodit Penal, **(në fuqi në vitin 2016)**, është parashkruar, pasi nga momenti i kryerjes së veprës penale që është periudha shtator 2016, ka kaluar afati 3 vjeçar.

Nga përlogaritja e afateve të parashkrimit të kësaj kundërvajte penale, rezulton se, në kushtet kur momenti i realizimit të veprës penale është muaji **shtator 2016**, dhe afati maksimal i ushtrimit të ndjekjes penale lidhur me këtë vepër është 3 vjet, atëherë ndjekja penale duhet të vazhdonte maksimalisht deri në muajin **shtator 2019**.

Pas periudhës **shtator 2019**, ndjekja penale sa i përket kësaj kundërvajte penale nuk mund të vazhdojë dhe për këtë shkak organi i Prokurorisë ka konkluduar se lidhur me këtë vepër penale çështja penale duhet të pushohet.

Sa i përket shtetasit nën hetim **Dionis Imeraj** dhe personave të tjerë të kallëzuar **Spartak Koltraka**, **Agron Malaj**, **Jetmir Lleshi**, **Shaban Uklala**, **Abaz Kaca**, **Sonila Ndreu (Braha)** dhe

Damian Gjicknuri, rezulton se ato nuk kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale “Dhënia e premtimeve dhe e shpërblimeve”, parashikuar nga neni 328/1 i Kodit Penal.

Nga hetimet e kryera, ka rezultuar se këto persona kanë patur një rol aktiv në fushatën e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Dibër, të zhvilluara në datën 11 shtator 2016, duke mbështetur politikisht kandidatin e Aleancës për Shqipërinë Europiane, (ASHE), por gjatë hetimit nuk është provuar që këto persona të kenë dhënë apo ofruar premtime dhe shpërblime apo të kenë përdorur forma të tjera të korrupsionit zgjedhor, me qëllimin për të votuar në një mënyrë të caktuar apo për të marrë pjesë ose jo në votime.

- Në lidhje me veprën penale “**Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje**”, kryer më shumë se një herë, parashikuar nga **nenet 329/3 i Kodit Penal, (në fuqi në vitin 2016)**, organi i Prokurorisë ka konkluduar se kjo vepër është kryer nga **shtetasit nën hetim Drini Gjeci dhe Hasan Hoti**, të cilët për këtë fakt penal janë marrë të pandehur, pasi secili prej tyre, provohet të ketë kanosur zgjedhësit më shumë se një herë, me qëllimin e posaçëm për të votuar në një mënyrë të caktuar.

- Sa i përket veprës penale “**Shpërdorimi i detyrës**”, parashikuar nga **nenet 248 i Kodit Penal, (në fuqi në vitin 2016)**, nga hetimet ka rezultuar se kjo vepër është kryer nga **shtetasit nën hetim Robert Aga, Drini Gjeci dhe Nuri Meda**, të cilët për këtë fakt penal janë marrë të pandehur, pasi secili prej tyre, në cilësinë e personave që kanë ushtruar një detyrë shtetërore, me veprimet apo mosveprime të kryera me dashje dhe në kundërshtim me ligjin, të cilat përbëjnë mospërmbyllje të rregullt të detyrës, kanë cënuar interesat e ligjshëm të shtetit dhe të shtetasve.

III. FAKTI PENAL DHE RRETHANAT E PROVUARA GJATË HETIMEVE

Me dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, **nr.9716, datë 02.08.2016**, është caktuar **data 11 shtator 2016**, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Dibër, pas shkarkimit me vendim qeverie të kryetarit të mëparshëm.

Disa ditë përpara datës së mbajtjes së zgjedhjeve, konkretisht me **datë 01.09.2016**, Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Shqipërisë, z.Edi Paloka, ka depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, një kallëzim penal, sipas së cilit, është pretenduar, se në territorin e bashkisë Dibër, një grup personash, të organizuar nga Partia Socialiste Dibër, në formën e grupit të strukturuar kriminal, nëpërmjet dhënies së shpërblimeve dhe premtimeve, ushtrimi të presionit dhe dhunës ndaj qytetarëve si dhe formave të tjera kriminale, synojnë të deformojnë vullnetin e zgjedhësve, në favor të kandidatit që garon nën siglën e Partisë Socialiste, në zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Dibër, të caktuara për t’u zhvilluar me datë 11 shtator 2016.

Nisur nga ky kallëzim, Prokuroria e Krimeve të Rënda, dy ditë përpara zhvillimit të zgjedhjeve, konkretisht me **datë 09.09.2016**, ka nisur hetimin penal, fillimisht nën dyshimin e kryerjes së veprave penale “Grupi i strukturuar kriminal”, “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve” dhe “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, parashikuar nga

nenet 333/a, 328 dhe 329, të Kodit Penal, dhe pas disa vendimmarrjeve të organit të hetimit, lidhur me ndryshimin e cilësimit juridik të veprave penale dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes për kompetencën e hetimit, të cilat janë cituar në mënyrë të detajuar në pjesën hyrëse të aktit, përfundimisht, hetimi i faktit penal ka vijuar për kompetencë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, me kualifikimin juridik, “Shpërdorimi i detyrës”, “Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve”, dhe “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, të kryera në bashkëpunim, (dhe jo në formën posaçme të grupit të strukturuar kriminal), parashikuar nga nenet 248, 328-25 dhe 329/3, të Kodit Penal, vepra të cilat gjatë hetimeve paraprahe, i'u janë atribuuar personave nën hetim: **1-Korab Lala, (i njohur ndryshe edhe si Imer Lala), 2-Robert Aga, 3-Dionis Imeraj, 4-Afrim Mikli, 5-Drini Gjeci, 6-Arben Keshi, 7-Hasan Hoti, 8-Bekim Krashi dhe 9-Nuri Meda.**

Nga aktet hetimore ka rezultuar se, menjëherë pas regjistrimit fillestar të procedimit penal, organi i Prokurorisë ka vijuar me një hetim proaktiv të çështjes, duke përdorur si mjet të posaçëm të hetimit, përgjimin e menjëhershëm të komunikimeve telefonike të personave të dyshuar dhe jo vetëm, të autorizuar me vendimet përkatëse të prokurorit të çështjes, të cilat janë miratuar më pas me vendimet **nr.628**, datë 10.09.2016; **nr.630**, datë 11.09.2016; **nr.631**, datë 11.09.2016; **nr.632**, datë 12.09.2016; **nr.633**, datë 11.09.2016; **nr.634**, datë 13.09.2016; dhe **nr.635**, datë 13.09.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Konkretisht përgjimet telefonike, janë kryer për një periudhë 15 ditore, nga data **09.09.2016 deri me datë 24.09.2016**, veç të tjerëve edhe ndaj pandehurve:

-**Robert Aga**, në atë kohë me detyrë Shef i Komisarariatit të Policisë Dibër, përdorues i numrit celular **068 20 44 141**.

-**Drini Gjeci**, në atë kohë me detyrë Drejtor i Drejtorisë Arsimore Rajonale Dibër, përdorues i numrit celular **068 23 50 139**.

-**Hasan Hoti**, në atë kohë me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Lurë, bashkia Dibër, përdorues i numrit celular **068 21 87 497**.

-**Nuri Meda**, në atë kohë me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Tomin, bashkia Dibër, përdorues i numrit celular **068 34 96 073**.

-Lidhur me të pandehurin **Robert Aga**, përdorues i numrit celular **068 20 44 141**, kanë paraqitur interes për hetimin këto komunikime:

-Nr.210, datë 09.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe shtetasit Arben Keshi, përdorues i nr.celular 069 20 45 812; Gjatë bisedës, Shefi i Komisarariatit të Policisë Dibër, Robert Aga, i thotë shtetasit Arben Keshi “kam nis ca shërbime policie atje, të FNSH-së nga dy grupe që bëjnë patrullime, bëjnë gjërat, porositi që janë në ndihmë të tyre...” dhe Arbeni i përgjigjet “në rregull, dakort, rrofsh...”. Roberti i thotë “do ti mbaj të dy aty deri nesër mbrëma gjithë natën, që të paktën njerëzit tonë të ndjehen të sigurtë të shkojnë të votojnë.Bëjua të qartë...” dhe Arbeni i përgjigjet “po po”. (Shkëputur nga transkriptimi i përgjimeve të subjektit Arben Keshi).

-Nr.213, datë 09.09.2016, bisedë ndërmjet shtetasit Arben Keshi, përdorues i nr.celular 069 20 45 812 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 069 29 20 162;

Menjëherë pas komunikimit me Shefin e Komisarariatit të Policisë Dibër Robert Aga, Arben Keshi telefonon një person të paidentifikuar, përdorues i numrit celular 069 29 20 162, të cilit i thotë “shif ki parasysh ato të tujt, ta dinë ato se janë t’u ardh një dy grupe të FNSH-së, që do patrullojnë nëpër Maqellarë, po ta dinë makinat tona...” dhe personi tjetër i përgjigjet “mirë, po a ti heqin ato do druna, do gjëja... ç’farë kanë...” dhe Beni i thotë “po po, ti heqin, nuk do jetë e nevojshme se do patrullojnë ato...” dhe personi tjetër i përgjigjet “në rregull, pa merak...”. (Shkëputur nga transkriptimi i përgjimeve të subjektit Arben Keshi).

-Nr.274, 275, 279, 291, datë 11.09.2016, komunikim me SMS, ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe një personi me emrin Gent, përdorues i nr.celular 068 80 43 330; Gjatë komunikimit me SMS, Genti i thotë Robertit: “Të lutem më kthe përgjigje, kanë filluar me i ndal furgonat në Tiranë, të lutem kije parasysh një furgon IVECO i Skënder Elezaj, është plot me njërezit tanë, mos ta ndalin.... Si të duhet targa ta dërgoj... Respekte Genti” dhe Roberti i kthen SMS ku i thotë “Ma dërgo...” dhe personi me emrin Gent i kthen SMS targën “AA 027 LI”.

-Nr.419, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 068 41 56 383; Gjatë bisedës, Roberti dhe personi tjetër bisedojnë nëse persona të caktuar i’ua kanë dhënë votat ose jo. Në bisedë e sipër, Roberti i thotë bashkëbiseduesit “më bjer numrin e Reshatit pasi nuk e kam dhe gjithashtu premtoi ndonjë gjë... se më tha tezen tënde nuk e ke parë hiç...” dhe personi tjetër i thotë “mirë, mirë...”.

-Nr.421, datë 11.09.2016, komunikim me SMS, ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe Administratorit të Njësisë Administrative Lurë Hasan Hoti, përdorues i nr.celular 068 21 87 497; Gjatë komunikimit me SMS, Hasan Hoti, i dërgon SMS Robertit ku i thotë “Bllokona Rufat Nezhën po i pate numrin, është me babën e tij...”.

-Nr.432, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe shtetasit Rifat Nezha, përdorues i nr.celular 069 51 61 338; Gjatë bisedës, Roberti i thotë Rufatit “A je me Hasanin apo jo...?” dhe Rifati i përgjigjet në mënyrë pohuese “Me kismet, ta kam thënë një llaf...”. Berti i’a kthen “Rrofsh, t’kam mik të mirë, do të ta shpërblej vëllai jot, zere se m’ke vëlla, ke unë e ke derën e hapur gjithmonë” dhe Rifati i thotë “shumë shumë, faleminderit...”.

-Nr.435, datë 11.09.2016, komunikim me SMS, ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe Administratorit të Njësisë Administrative Lurë, Hasan Hoti, përdorues i nr.celular 068 21 87 497; Pas komunikimit me shtetasin Rifat Nezha, Roberti i kthen përgjigje shtetasit Hasan Hoti, duke i thënë “Fola tani dhe është me ne...”.

-Nr.436, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 068 26 90 563; Gjatë bisedës, Roberti i thotë bashkëbiseduesit: “Shko njëherë mbështilli çato njerëz të shkojnë të votojnë, shpirt të kam...” dhe personi i përgjigjet

“të rrish pa merak, top i ke”. Roberti i thotë përsëri “shpirt të kam” dhe sërish bashkëbiseduesi ia kthen “Top i ke”. Roberti i thotë “je shumë i mirë”.

-Nr.493, datë 11.09.2016, komunikim me SMS, ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe Administratorit të Njesisë Administrative Lurë, Hasan Hoti, përdorues i nr.celular 068 21 87 497; Gjatë komunikimit me SMS, Hasan Hoti, i dërgon SMS Robertit ku i thotë “Lutfi Bucin shife...”

-Nr.515, datë 11.09.2016, komunikim me SMS, ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe shtetasit Lutfi Buci, përdorues i nr.celular 068 34 42 828; Gjatë komunikimit me SMS, Lutfi Buci, i dërgon SMS Robertit ku i thotë “Përshëndetje, që të jesh i sigurtë ti, a do ti boj votat me filmim a me dëshmitar.Lutfi Buci”.

-Nr.544, datë 11.09.2016, komunikim me SMS, ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe shtetasit Lutfi Buci, përdorues i nr.celular 068 34 42 828; Gjatë komunikimit me SMS, Roberti, i dërgon SMS Lutfi Bucit ku i thotë “Me dëshmitar apo me filmim unë besoj tek miku im Lutfi Buci...”

-Nr.595, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 069 51 61 338; Gjatë bisedës, bashkëbiseduesi i thotë Robertit “Tani o Bert nuk e di, janë nxehur këto të PS -së së Lurës, jo kam hy vetëm jo skam hy me kto me votu”.Roberti i thotë “A i’u the që ia kam dhënë Bert Agës...” dhe personi i përgjigjet “Unë ta dhashë llafin që do të ta jap, tani kto më çmendin, më thonë ia ke dhënë PD -së.Tani nuk e di...”. Berti i thotë “ja të flas unë, po çoje mamin që të votojë ti...” dhe personi i thotë “ja po ik mami tani...”.Berti i thotë “çoje mamin që të votojë hapur ajo dhe mirupafshim...” dhe personi i thotë “Mera më ka thënë mua personalisht nëse nuk voton për mua je i heqëm dhe unë i thashë vetëm hiqëm” dhe Berti i thotë “të çon vëllai jot...”

-Nr.677, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe Kryetarit të PS -së Afrim Mikli, përdorues i nr.celular 068 45 07 265; Gjatë bisedës, Roberti i thotë Afrimit “ne duam një informacion se jemi në ankth...?Si i kemi punët...? I kemi çu njerëzit lart...?” dhe Afrimi i përgjigjet “po po”. Roberti e pyet “Mirë...?” dhe Afrimi përgjigjet “mirë them”.

-Nr.697, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 069 33 08 338; Gjatë bisedës bashkëbiseduesi i thotë Robertit “ma ço atë makinën si janë ato tre policët mi lër aty në Kandër...” dhe Roberti i përgjigjet “po po”. Pas këtij momenti biseda me këtë person ndërpritet dhe Roberti fillon të bisedojë me një person tjetër. Gjatë kësaj bisede Roberti e pyet bashkëbiseduesin “Si duket...?” dhe ai i përgjigjet “Çka, ai Kiçi Islami (bëhet fjalë për Islam Kiçin) na e futi ja qifisha robt...”, Roberti i thotë “ashtu ëëë...?” dhe personi ia kthen “I dola borxhit, i thashë a do lekë dhe tha jepke pak, du më shumë...”

-Nr.729, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 068 41 56 383; Gjatë bisedës, bashkëbiseduesi i thotë Robertit: “merre në telefon Gysin të shkon atje se nuk ka ardh Gysi ala (akoma)...” dhe Roberti i përgjigjet “po po, se di a e kam numrin, duhet ta kem...”.

-Nr.732, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe personit me emrin Gysi, përdorues i nr.celular cel 068 68 71 666; Gjatë bisedës Roberti e pyet Gysin “Kur do shkosh mo...?” dhe Gysi i përgjigjet “ja tani jam tu u nis se kisha shumë punë...”. Roberti i thotë “hajde tani, të lutem...”. Gysi e pyet “a je aty...?” dhe Roberti përgjigjet “çke ti se ku jam unë...”. (Nga biseda kuptohet se personi me emrin Gysi nuk ka ardhur për të votuar dhe Roberti e merr në telefon që ai të vijë të votojë).

-Nr.735, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 068 41 56 383; Pas telefonatës me Gysin, Roberti i kthen përgjigje personit përdorues i nr.celular 068 41 56 33, duke i thënë “Ok, në rregull...”. (duke nënkuptuar se e kishte lajmëruar Gysin që të vijë të votojë).

-Nr.741, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 069 36 21 826; Gjatë bisedës, bashkëbiseduesi i thotë Robertit: “Merre një çikë vocin Nuz Hames, bëji një çikë presion këtij legeni...” dhe Roberti i thotë “patjetër...”.

-Nr.751, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe personit me emrin Qemal, përdorues i nr.celular cel 068 25 38 685; Gjatë bisedës, Roberti i thotë personit me emrin Qemal “Shife atë djalën e atij Hames, hë më se e ke parasysh, ia ke telefonin ti se i kërkojnë të shkojnë të votojnë” dhe Qemali i përgjigjet “po po, se e gjej unë për dy minuta”. Roberti i thotë “shko thuaji për hatër tim”.

-Nr.779, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe shtetasit Dik Spata, me detyrë Administrator i Njësisë Administrative Fushë Çidhën, përdorues i nr.celular cel 068 32 18 268; Gjatë bisedës, Roberti e pyet Dikën: “Hë a je ...?” dhe Dika i përgjigjet “Deng mor...” dhe Roberti ia kthen “A të marsha të ligat”. Roberti e pyet “a ke dhe shumë ?” dhe Dika i përgjigjet “Jo, në përfundim”. (Në këtë bisedë kuptohet interesi i subjektit nëse rezultati i votimit është pozitiv).

-Nr.787, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe punonjësit të policisë Azbi Biçi, përdorues i nr.celular cel 068 52 69 888; Gjatë bisedës, Azbi Biçi, punonjës policie në Komisariatin Dibër, i raporton eprorit të tij Robert Aga, Shef i Komisarariatit të Policisë Dibër, duke i thënë “Sa jam nisur me kutitë e Bllatës së Poshtër” dhe Roberti i thotë “me kujdes”. Në bisedë e sipër, Roberti i thotë Azbiut “Ti i ke çu njerëzit e tuj të votojnë...?” dhe Azbiu përgjigjet “patjetër që po..., i kam çu me makinë dhe i kam afër...”.

-Nr.995, datë 12.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular cel 069 32 82 538; Gjatë bisedës, bashkëbiseduesit diskutojnë mbi rezultatin e thellë të fitores së PS -së, ku ndër të tjera personi e pyet Robertin: “Ça bëtë ashtu, në progresion gjeometrik...?!” dhe Roberti përgjigjet “po pra mo tashi, unë kur të fitoj mandatin, kam të drejtë t’i them atij burrit të huaj që unë e mbarova” dhe personi ia kthen “po po, e bëre asfalto beton rrugën, e shtrove rrugën e Arbrit” dhe Roberti i përgjigjet “po po”.

-Nr.1009, datë 12.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe shtetasit Bekim Krashi, përdorues i nr.celular cel 069 29 99 993; Gjatë bisedës, Bekimi dhe Roberti të entuziazmuar komentojnë fitoren e thellë të PS -së. Bekimi i thotë Robertit “Ça keni bo, ça keni bo mo se e keni myt fare?! Jeni t’u e myt sjeni tu lënë gjë me bë, plus kudo jeni, vetëm në Çernenë jeni tani minus dhjetë. Do ti nxjerr dhe do ti jap me letër këtu”. Roberti i përgjigjet “Duhet të kem 1000, poshtë një mijëshit nuk e pranoj”. Bekimi i thotë “Ça fol mo ça fol, ke fillu pretendime të mdhoja”. Ndër të tjera Roberti i thotë Bekimit “Ej, ajo strategjia ime funksionon, po pak, vetëm atë ditë” dhe Bekimi ia kthen “E di mo e di.Ti e ke deklaruar je komisar politik dhe pastaj qesh...”. Gjatë bisedës Roberti e pyet Bekimin “A e ke Damian Gjijnurin aty ?” dhe Bekimi i thotë “Do tia jap telefonin ti folësh ?” dhe Roberti ia kthen “Jepja pak, jepja pak”. Pastaj në bisedë ndërhyjnë Damian Gjijnuri i cili i thotë “O shef, o Berto?” dhe Berti përgjigjet “Mirmroma”.Damiani i thotë “Hë mo ça bo” dhe Berti ia kthen “Hë si je?”, Damiani përgjigjet “Mirë, tullë, mirë fare”.Berti i thotë “Se s’pate besim te unë” dhe Damiani ia kthen “Tërmet, tërmet.Ti ishe bob.Thoshe ti.... hahaha i madh.hajt çao.Ik mos fol shumë po hajt çao”.

-Nr.1245, datë 12.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe personit me emrin Ylli, përdorues i nr.celular cel 069 20 69 698; Gjatë bisedës, ndër të tjera Ylli e pyet Robertin: “Si shkuat, si është situata?”, Roberti i përgjigjet “Mirë mo, i kam gropos...”. Ylli i thotë “tani po ta hëngrën hakun nëna i’u qift”, Roberti i përgjigjet “se di vallaj, më shumë se aq skam ça bëj...” dhe Ylli ia kthen “ja ja, mirë jemi, mirë duket...”.

-Nr.2009, datë 13.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe personit me emrin Juli, përdorues i nr.celular cel 067 40 50 505; Gjatë bisedës, Juli i tregon Robertit se një person ka bërë një video dhe është nisur në drejtim të Tiranës për ta dërguar në televizion dhe sipas informacionit të Julit, ky person është nisur me furgon dhe në Shupenzë ka marrë një Benz dhe është nisur për në Tiranë. Juli e pyet Robertin nëse kanë ndonjë mundësi për t’a ndaluar Benzin dhe Roberti i përgjigjet “po mor, po më jepni një targë a një numër telefoni...”. Juli i thotë që targën nuk e kanë por sipas tij personi që ka bërë videon është jevg.

-Nr.2012, datë 13.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe personit me emrin Juli, përdorues i nr.celular cel 067 40 50 505; Gjatë bisedës, ndër të tjera, Juli i thotë Robertit se

personi quhet Blerim Bajrami, nga Sohodolli, komuna Kastriot dhe është jevg. Sipas të dhënave që Juli i jep Robertit, ky person në Shupenzë ka ndërruar furgonin dhe ka hipur në një Benz dhe tani mbase e ka kaluar Bulqizën dhe çështja është që të ndalohej nga Klosi dhe ato të shkojnë ta marrin për në Peshkopi. Pas marrjes së të dhënave, Roberti i thotë Julit “ja po i nxjerr në Klos” dhe Juli i thotë “në rregull”.

-Nr.2018, datë 13.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe personit me emrin Juli, përdorues i nr.celular cel 067 40 50 505; Gjatë bisedës, Roberti i kërkon edhe njëherë emrin e personit që duhet të ndalojnë dhe Juli i përgjigjet se emrin e ka Blerim Bajrami dhe do i'a dërgojë edhe me mesazh.

-Nr.2021, 2024, 2025, datë 13.09.2016, komunikim me SMS ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe personit me emrin Juli, përdorues i nr.celular cel 067 40 50 505; Juli i dëgon SMS Robertit duke i treguar të dhënat që disponon për personin që do ndalojnë dhe konkretisht: “Blerim Bajrami, 28/11/1994”, “Benz i Zi, Class 220, me portobagazh. Janë afër Burrelit”, “Janë dy vetë para ky personi mbrapa”.

-Nr.2026, datë 13.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe personit me emrin Juli, përdorues i nr.celular cel 067 40 50 505; Gjatë bisedës, Roberti i thotë Julit: “Nisuni për andej ju se jua dhashë atyre shërbimeve...” dhe Juli i përgjigjet “po po, u nisëm ne, në Bulqizë jemi”. Roberti i thotë “hajde, ia ka dhënë atij të Klosit...”.

-Nr.2031, datë 13.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe personit me emrin Juli, përdorues i nr.celular cel 067 40 50 505; Gjatë bisedës, Juli i thotë Robertit që personi duhet ta ketë kaluar Klosin ose Burrelin dhe gjithashtu i kërkon Robertit që t'i nxjerrë ndonjë tek dy rrugët ku ndahet Burreli dhe Roberti i përgjigjet “ja ta marr njëherë atë të Burrelit...”. Gjatë bisedës Roberti e pyet Julin “po mirë, a nuk ra dakort ai...?” dhe Juli i përgjigjet se ato nuk e kishin kuptuar që në fillim por më pas, dhe derisa kishin hapur kamerat dhe e kishin gjetur që ai kishte bashkëpunuar një person nga Maqellara, ai ishte larguar duke hipur në një furgon. Gjatë bisedës, Juli i thotë Robertit se dikush po i thotë se ky person bashkë me këtë të Maqellarës janë bashkuar nga Qafa e Buallit. Berti e pyet “Kush është ky i Maqellarës?” dhe Juli i përgjigjet “është një person tjetër, edhe ky jevg është, nga Vojnika, Shpëtim Cak (nuk kuptohet mbimeri)”. Roberti i thotë “ja të marr Burrelin...”.

-Nr.2035, datë 13.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe punonjësit të policisë rrugore të Burrelit me emrin Bardhi, përdorues i nr.celular cel 068 53 34 200; Gjatë bisedës, Roberti i thotë Bardhit: “Bardhi, të lutem miqësisht... . Do vijë një Benz, portobagazh, 220, C Class, dhe aty në makinë është një Blerim Bajrami, ka diçka, një material aty që nuk duam të na e çojë nga Tirana... . Është bashkë me një tjetër. A mund t'i ndalosh të dy ato se po vjen një makinë tjetër mbas tyre për të kontaktuar...?” dhe Bardhi i thotë “po. 220 ç'a ngjyre është?” dhe Roberti i thotë “ngjyrë e zezë, C Class”. Bardhi e pyet “Ça të bëj me atë” dhe Roberti i thotë “po hiç mo ndaloje, çoji përpara komisarariatit dhe lidhuni bashkë, për verifikim thuaji... . Gjej modalitete...”. Bardhi e pyet “Ta çoj në

Komisariat me gjithë personat?” dhe Roberti përgjigjet “jashtë komisariatit, derisa ashtu, se rrezik kanë ardh ato...”.

-Nr.2037, datë 13.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe personit me emrin Juli, përdorues i nr.celular cel 067 40 50 505; Gjatë bisedës, Roberti i thotë Julit: “Juli, unë e kam nxjerrë edhe postblllok në Burrel, mu ke ura e Burrelit... . Ja dhashë llojin e makinës, personat e kto dhe është vetë shefi i qarkullimit aty.Është aty aktualisht.Kshu që ju vazhdoni rrugën.Në rregull...?” dhe Juli i përgjigjet “në rregull...”.

-Nr.2040, datë 13.03.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe punonjësit të policisë rrugore të Burrelit me emrin Bardhi, përdorues i nr.celular cel 068 53 34 200; Gjatë bisedës, Bardhi i thotë Robertit “U lidha me shefin e komisariatit, unë këtu dola këtu në pritje, tha thuaqi shef Bertit që të lidhet me sallën (fjala për sallën operative), që ta marrë nëpërmjet sallës...” dhe Berti i thotë “po t’i them...”.

-Nr.2046, datë 13.03.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe punonjësit të policisë rrugore të Burrelit me emrin Bardhi, përdorues i nr.celular cel 068 53 34 200; Gjatë bisedës, Bardhi i thotë Robertit: “Unë e kam ndaluar këtë mjetin, ia dhashë sallës si targë, i thashë po të verifikojmë për gjoba e kshu. Tani këtu e kam unë dhe salla tha prit të të them unë...”. Roberti e pyet “Kush është ai djali...?” dhe Bardhi i përgjigjet “Haki Keta është drejtuesi i automjetit”. Roberti e pyet po ky djali a është aty, ai tjetri që duam ne...?” dhe Bardhi e pyet “si e ka emrin?” dhe Roberti i përgjigjet “me mbiemër Bajrami..., ja ta jap unë emrin, mbylle të marr këtë...”.

-Nr.2048, datë 13.03.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe punonjësit të policisë rrugore të Burrelit me emrin Bardhi, përdorues i nr.celular cel 068 53 34 200; Gjatë bisedës, Roberti i jep të dhënat e personit Bardhit dhe konkretisht “Blerim Bajrami...” dhe Bardhi i thotë “ja ta shof...”.

-Nr.2053, datë 13.03.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe punonjësit të policisë rrugore të Burrelit me emrin Bardhi, përdorues i nr.celular cel 068 53 34 200; Gjatë bisedës Bardhi i thotë Robertit: “O shef Berti, nuk është ai emër, janë nja dy gra dhe njëri është kosovar...” dhe Roberti i thotë “po lëre, shife se vjen tjetri mbrapa, vjen tjetër makinë mbrapa, nuk është ky, është dikush tjetër...” dhe Bardhi i thotë “dakort...”.

-Nr.2058, datë 13.09.2016, komunikim me SMS ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe personit me emrin Juli, përdorues i nr.celular cel 067 40 50 505; Juli i dëgon SMS Robertit ku i thotë: “E paskan kaluar Rrëshenin.Paskan ec goxha. Tashi të shohim ça do nxjerrin sonte kto në TV...”.

-Nr.2178, datë 13.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe shtetasit Xhemal Qefalia, përdorues i nr.celular 069 20 90 786; Gjatë bisedës, Xhemali i thotë Robertit: “Ej jam me një tavolinë kshu, ku ke qef me shku ti në Bulqizë...? dhe Roberti përgjigjet “Po...”. Xhemali i

thotë “Ok hajt, çao...”. Roberti e pyet “Kush thotë...?” dhe Xhemali përgjigjet “Jemi këtu me kryeministrin dhe ministrin...”. Roberti i thotë “Jo jo, unë u garantoj, t’u jap ç’farë t’u dojë qefi. Më çoni për zgjedhje...”. Xhemali i thotë “ku e do...? Që mos biem atë Ben Keshin aty, si thu...?” dhe Roberti përgjigjet “Shumë mirë mo është...” dhe Xhemali i thotë “hajde”. Roberti në mënyrë mosbesuese i thotë “Tall bythën...”, Xhemali i përgjigjet “Për kok tate po. Do foto? Do foto ta dërgoj? dhe Roberti sërish mosbesues ia kthen “Je me noj dashnore aty...”.

-Nr.2179, datë 13.03.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe shtetasit Xhemal Qefalia, përdorues i nr.celular 069 20 90 786; Gjatë bisedës, ndër të tjera, Xhemali i nxjerr Robertit në telefon Ministrin e Brendshëm (të kohës) Sajmir Tahiri dhe më pas biseda vazhdon ndërmjet Robertit dhe Sajmir Tahirit. Ndër të tjera, Sajmiri i thotë Robertit: “faleminderit shumë për angazhimin, je i madh...” dhe Roberti i përgjigjet “e kam detyrim...”. Sajmir Tahiri i thotë sërish Robertit “Je i madh dhe mos e rruj k... për atë që thonë ata se sna ha trapi ne për ata legena...”, ndërsa Roberti i thotë “unë jam ushtari jot...”. Pas këtij momenti, Sajmir Tahiri përshëndet Robertin dhe më pas biseda vazhdon me shtetasin Xhemal Qefalia, i cili i thotë Robertit “ke të fala nga Ulsiu” dhe më pas mbyllet biseda.

-Nr.2180, datë 13.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe shtetasit Xhemal Qefalia, përdorues i nr.celular 069 20 90 786; Gjatë bisedës Xhemali i kalon Robertit në telefon deputetin Ulsi Manja dhe më pas biseda vazhdon ndërmjet Robertit dhe Ulsiut. Pasi Roberti përshëndetet me Ulsiun ku ky i fundit i thotë që është me kryeministrin, Roberti i thotë Ulsiut “mu më duhet me shku pak atje...”, Ulsiu e pyet “ku mër...?” dhe Roberti i përgjigjet “ke Bulqiza, po u ndrrum...”. Ulsiu i thotë “ne thomi të shkojsh për ma nalt or burrë...”. Roberti i thotë “mirë mirë, ju e dini tashi...”. Ulsiu i thotë “tani a do më ngjosh mu, bisedo me Xhemalin se kët e kum si shefin e Komisionit të Sigurisë, ne bëjmë llaf të vish për ma nalt, na duhesh për naj gjë ma të madhe se mu m’duken xhëna të vogla ato o miku im...”, Roberti ia kthen “mirë mo mirë...”. Ulsiu i thotë “mbaje Xhemalin në korent se kët kemi autorizim si kryetar komisioni...”. Berti i thotë “Xhemalin e kam pas vartës”, Ulsiu i thotë “Or o kryetari i komisionit të sigurisë, e kimi si shef kët, dakort?”. Berti ia kthen “Pyte, ai thotë jam ushtari Bertit thotë, se Berti ka qenë komandanti im”. Ulsiu i thotë “Në rregull në rregull, hajde pra...” dhe Berti e përshëndet “Hajde mirupafshim”. Në këtë moment në bisedë ndërhyjnë përsëri Xhemal Qefalia i cili i thotë Bertit “Hë mër ti, m’çan trapin mu, kush jam unë...?!”, Berti i thotë “Ej, po si o ma nxjerr ministrin në telefon, o koqe?!” dhe Xhemali përgjigjet “Ej, po je shoku im ti or burrë, mos m’çaj karin mu. A do të qis Ramën, ti folësh Ramës i çik ktu?” dhe Berti përgjigjet “Po lëre o vlla tashi, shif ma boj atë, të shkoj anej nga Bulqiza njer...”. Xhemali i thotë “Mos na çaj bythën tashi. A je shoku im ti? Mos na çaj bythën”, Berti i përgjigjet “Unë ashtu kam qenë e do jem”. Xhemali i thotë “Hajde vlla çao” dhe Berti i thotë “Hajde gjithë të mirat”.

-Nr.2347, datë 14.09.2016, bisedë ndërmjet Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, shtetasit Robert Aga, përdorues i nr.celular 068 20 44 141 dhe shtetasit Xhemal Qefalia, përdorues i nr.celular 069 20 90 786; Gjatë bisedës, Xhemali i thotë Robertit: “Çe vret trunin mo burrë, të plasi bytha. Flamuri është i detyruar të bëjë politikë, po do i themi ne

nesër s'ke pse e përmend më atë". Roberti i thotë "jo më jo, ai le të vijë të kontrollojë ku ti dojë qefi..." dhe Xhemali ia kthen "po ku ka o vlla, ç'ja fut kot ai, ato mundohen me u justifiku. A e merr vesh ça bëhet mrena PD së, sot janë tu u zi (zënë) me njëri-tjetrin. Mos e vrit mendjen o burrë po he". Roberti i thotë "ju pata thënë unë, ma blini kartonin si Messi që ia mban Barcelona dhe të fitoni..." dhe Xhemali ia kthen "po ja fusin kot ato o vlla, të të kishin vu ty atje, e fitojshin ato". Roberti i thotë "ore unë jam pjesë e PS -së dhe nuk ndërroj për 1 milion vjet...", Xhemali i përgjigjet "nuk e vej në dyshim o vlla, unë prandaj e thashë mbrëm, aty ishin të gjithë grupi i PS -së, se besojshin më, ishte grupi parlamentar". Roberti i thotë "po lere lere, shyqyr që nuk thashë noj fjalë tjetër. Unë e disha se është Gjiknuri". Xhemali i thotë "se besojshin që ne ishim atje ere?" dhe Roberti përgjigjet "po jo mo thashë ishte ajo orë tashi, çne ky me shefin!". Xhemali i thotë "ishte Gramozi, ishte dhe Rama aty, ishin të gjithë dhe ra muhabeti jot, foli shumë mirë dhe Damiani, në fakt dhe Blerina dhe gjithë kto dhe i thashë që ai do kalu, e keni çu atje, alamet..., ai bo punë edhe ktej. I thashë edhe atij Ulsiut që ta përforcojë që thashë mos kishte kundërshtim. I thashë mu më bën punë dhe në Tironë ai, po puna është që edhe atje ku është ai i jep drejtim". Berti i thotë "Ëhë, ishalla mos më çojnë nga Bulqiza njer ktej...", Xhemali ia kthen "E pra e, edhe çlodhesh i çik të pushojsh". Berti i thotë "Jo, kam nevojë të pushoj pak, sinqerisht...". Xhemali e pyet "Ej ikën ato, ikën e?" dhe Berti përgjigjet "Po po, i përçolla tashi, të lumtur". Xhemali i thotë "Për drekë ça u bo o vlla?" dhe Berti përgjigjet "Jo mo hëngrën, se di ça bënë mo, koktej a drekë" dhe Xhemali i thotë "Drekë, drekë". Berti i thotë "Mirë o shefi im". Xhemali i thotë "Hajde o vlla mos e çaj trapin, të bohet kjo, më e mira, mos e vrit mendjen, ta tha edhe mbrëmë ai ty mos ashtu gjë nga kto". Berti i thotë "Jo, ai ma tha në ligjëratë të drejtë, e shpërlau gojën...". Xhemali i thotë "Po prandaj pra them unë". Berti i thotë "Mirë vlla, hajde të përshëndes shumë" dhe Xhemali ia kthen "çao".

-Lidhur me të pandehurin Drini Gjeci, përdorues i numrit celular 068 23 50 139, kanë paraqitur interes për hetimin këto komunikime:

-Nr.9, datë 09.09.2016, bisedë ndërmjet Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr. celular 068 26 50 139 dhe një punonjësje të Drejtorisë së Arsimit Dibër, të quajtur Sabrie, përdoruese e nr. celular 068 33 87 655; Pas komunikimit me tyre lidhur me një problem pune, në fund të bisedës, Drini me ton urdhërues i thotë Sabries: "edhe bëhuni gati për takim atje poshtë, dilni të gjithë atje poshtë...". (nga kjo bisedë kuptohet se Drejtori i DAR Dibër, Drini Gjeci, urdhëron punonjësit e DAR Dibër, që të shkojnë në mitingun përmbyllës të Partisë Socialiste, i cili nga verifikimet rezulton të jetë zhvilluar me datë 09.09.2016, ditë e premte, pune).

-Nr.14, datë 09.09.2016, bisedë ndërmjet Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr. celular 068 26 50 139 dhe Kryetarit të PS -së Dibër, Afrim Mikli, përdorues i nr. celular 068 45 07 265; Gjatë bisedës, Afrimi e pyet Drinin: "këto drejtorët i ke marrë besoj për sot ëë...?" dhe Drini i përgjigjet "po mor i kam marrë në telefon ato...". (Edhe në këtë bisedë kuptohet se Drejtori i DAR Dibër ka njoftuar drejtorët e shkollave për të marrë pjesë në mitingun përmbyllës të Partisë Socialiste, të zhvilluar me datë 09.09.2016).

-Nr.15, datë 09.09.2016, bisedë ndërmjet Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr. celular 068 26 50 139 dhe Drejtorit të Gjimnazit Maqellarë, Gëzim

Qoku, përdorues i nr.celular cel 068 64 34 658; Gjatë bisedës, Drini e pyet Gëzimin: “O Gzim ku je...?”, Gëzimi përgjigjet “duke ardhur për Peshkopi...”. Drini e pyet “A keni njoftim për sot or ti...?” dhe Gëzimi i përgjigjet “posi or ti”. Drini e pyet “mësuesit a i keni njoftuar...” dhe Gëzimi i përgjigjet “po po”. (Edhe në këtë bisedë kuptohet se Drejtori i DAR Dibër vazhdon me njoftimin e drejtorëve e shkollave dhe mësuesve për të marrë pjesë në mitingun përmbyllës të Partisë Socialiste, të zhvilluar me datë 09.09.2016).

-Nr.16, datë 09.09.2016, bisedë ndërmjet Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr.celular 068 26 50 139 dhe një personi të quajtur Arian (dyshuar drejtor shkolle), përdorues i nr.celular cel 068 61 53 600; Gjatë bisedës, Drini e pyet Arjanin: “nga je...?” dhe Arjani i përgjigjet “duke ardhur për Peshkopi...”. Drini e pyet “a keni bërë njoftim mësuesish...?” dhe Arjani i thotë “ç’farë njoftimi psh...?”, Drini përgjigjet “për sot mo takimin...” dhe Arjani i përgjigjet “po mor po, t’u ardh jam me mësuesit...”. (Edhe në këtë bisedë kuptohet se Drejtori i DAR Dibër i njofton vartësit e tij (mësuesit) për të marrë pjesë në mitingun përmbyllës të Partisë Socialiste, të zhvilluar me datë 09.09.2016).

-Nr.57, 58, datë 09.09.2016, komunikim me SMS, Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr.celular 068 26 50 139 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular cel 069 20 33 847; Gjatë komunikimit, personi i dërgon SMS Drinit ku e pyet: “si shkoi mitingu...?” dhe Drini po me SMS i përgjigjet “Shumë mirë...”. (Edhe nga ky komunikim rezulton se në datën 09.09.2016 ka patur miting dhe Drejtori i DAR Dibër ka marrë pjesë bashkë me mësuesit që rezulton ti ketë njoftuar në bisedat e mësipërme).

-Nr.96, datë 09.09.2016, bisedë ndërmjet Drejtorit të Arsimit Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr.celular 068 26 50 139 dhe shtetases Gjylsime Topalli (dyshuar drejtoreshë shkolle në zonën Maqellarë), përdorues i nr.celular 066 66 28 932; Gjatë bisedës, Drini e pyet Gjylsimen lidhur me mësuesen e anglishtes të quajtur Rozeta Xholi dhe Gjylsimja i përgjigjet “është mësuese shumë e mirë, është e djathtë por është shumë shumë e mirë. Është njëshi i anglishtes jo këtu, në rrethin e Dibrës. Ka mbaru me të gjitha dhjeta”. Drini e pyet “a ka licencë?” dhe Gjylsimja i përgjigjet “Po po, nuk e ka kap ajo, sistemi”. Drini e pyet Gjylsimen “ke bisedu ti me të apo jo...?” dhe Gjylsimja i përgjigjet “si s’kam bisedu me të...?! Kam bisedu me të, ajo thotë votat janë të fshehura, votat do jua jap juve por nuk mund të dali absolutisht/hapur pasi është kunata e Ylber Dacit”. Drini e pyet “dmth nuk na bën dëm...?” dhe Gjylsimja i përgjigjet “ajo thotë do votoj po unë nuk e di...”. Drini i mërzitur i thotë “aman moj aman si ju rrejnë, i shoqi sot krah për krah me Lul Bashën në takim...”, Gjylsimja i thotë “po ç’a krah për krah, i shoqi Adriatik Xholi është kryetar komisioni në Kërçisht”.

-Nr.207, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Drejtorit të Arsimit Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr.celular 068 26 50 139 dhe shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073; Gjatë bisedës, Nuriu i thotë Drinit: “ç’farë do bëjmë me një Halil Kaba që kemi pas shkruajt ke ato letrat se ka ardhur vetë i teti. E kemi pas shkrujt ke ato letrat për ti paguar rrugën vajtje ardhje po ai do ndonjë gjë...merre njëherë Afrimin. Drini ia kthen “mirë”.

-Nr.216, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Drejtorit të Arsimit Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr.celular 068 26 50 139 dhe shtetasit Halim Bojku, përdorues i nr.celular 068 47 90 574; Gjatë bisedës, Drini i thotë Halimit: “më mori Nuriu për atë Halil Kabën, dhe Nuriu më tha fol me Afrim Miklin dhe Halim Bojkun, ku e di unë tani, nuk e marr vesht, lidhu më mirë me nuriun vetë...” dhe Halimi i përgjigjet “unë kam fol me Nuriun dhe më tha ta shkatërrojmë at punë ...(nënkuptohet që ti japin paratë për votat)” dhe Drini i thotë “po nuk e shkatëroj dot unë se...(nënkuptohet që paratë tia japin ato)” dhe Halimi i përgjigjet “po mirë mo se e shkatërroj unë pra” dhe Drini i përgjigjet “po lidhu njer me Nuriun thua, ç’farë, ku qysh?”.

-Nr.205, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr.celular 068 26 50 139 dhe shtetasit Arben Keshi, përdorues i nr.celular 068 20 45 812; Gjatë bisedës, Drini e pyet Arbenin: “A thu të kan ndihmu ato drejtorët e shkollave?” dhe Arbeni i përgjigjet “merri në telefon një nga një, ditën e hënë keni shku për lesh... merri njëherë të raportojnë se kë kanë marrë në telefon se jan tu fjet gjumë...”. Arbeni i thotë “Përveçse me Gëzimin dhe Arjanin, me asnjërin nuk kam fol”. Drini i përgjigjet “ja ti marr Drini...”. Arbeni i thotë “merri dhe tia kujtoni një më një të gjithë mësuesve sipas listës që keni sjellë, nëse duan të jenë në punë. Nëse nuk duan në pidh të nënës të shkojnë”.

-Nr.392, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr.celular 068 26 50 139 dhe deputetit Pjerin Ndreu, përdorues i nr.celular 068 20 61 822; Gjatë bisedës, Pjerini i thotë Drinit “Pjerin Ndreu jam. Si je?” dhe Drini përgjigjet “Po Pjerin, si kalon?”. Pjerini i thotë “Bëji një telefon këtij Reshat Elezit, këtij Drejtorit të Reçit, Drejtorit të shkollës, thua me deklarë votën hapur se ato sms-të që i çon poshtë e përpjetë nuk janë shumë të këndshme, deklarë votën hapur se e ke për PS-në ndryshe ditën e hënë tregoj ku fluturon”. Drini e pyet “Reshat Elezaj?” dhe Pjerini i përgjigjet “Po”. Drini i thotë “Flas unë tashi me të”. Pjerini i thotë “tregoj se ku fluturon të hënë, të deklarë votën hapur për PS-në aty. Nuk e deklarë votën hapur për PS-në me gjithë vlla...” dhe Drini ia kthen “rri pa merak shefi se e mbuloj unë këtë punë”.

-Nr.393, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr.celular 068 26 50 139 dhe shtetasit Reshat Elezaj, Drejtor i Shkollës së Reçit, përdorues i nr.celular 068 64 33 077; Gjatë bisedës, Drini i thotë Reshatit: “Ku je?”, Reshati përgjigjet “tu ra ke qendra e votimit...”. Drini e pyet “I ke marrë të gjithë ato të familjes...?” dhe Reshati i përgjigjet “Nuk jam tu ra me votë tani, më vonë”. Drini e pyet “në ç’farë qendre voton ti ...?” dhe Reshati i përgjigjet “këtu në Zall Reç...”. Drini me ton kërcënues i thotë “Dëgjo se kam informacione jo të mira andej unë Sot vota jotë një, dhe e familjes tënde dy, do të deklarohen haptas. Nuk ke deklarë votën haptas sot bashkë me familje....gjej ku të shkosh...”. Reshati i thotë “Drejtor mos e vrit mendjen me atë punë fare...”. Drini përsëri me ton kërcënues vazhdon “ore do të deklarohet haptas, haptas. Kur them haptas, haptas...” dhe Reshati përgjigjet “po mos e vrit mendjen fare, pa merak, pa merak”. Drini i thotë përsëri “haptas me gjithë familjen...” dhe Reshati përgjigjet “pa merak, pa merak”.

-Nr.394, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr.celular 068 26 50 139 dhe deputetit Pjerin Ndreu, përdorues i nr.celular 068 20 61 822; Gjatë bisedës, Drini ndër të tjera i thotë Pjerinit: “Unë ia thashë llafet e mia po ti në rast se ke një person atje, në rast se ju keni noj person atje, mund ta merrni t’ja verifikoni.Haptas i kam thënë”.Pjerini i thotë “me shku tek administratori atje me u marr me të, me shku me deklarë votën, ndryshe pastaj është i pa sigurtë” dhe Drini përgjigjet “Po leje se e rregulloj unë atë punë, me atë pjesë merrem unë”.Pjerini i thotë “thua ja këtë që të thashë unë, takoje administratorin aty dhe shkoni me atë”.

-Nr.517, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr.celular 068 26 50 139 dhe shtetasit shtetasit Lavdrim Murati (dyshohet mësues në Reç), përdorues i nr.celular 068 25 48 776; Gjatë bisedës, Drini i thotë Lavdrimit: “Lavdrim Murati...?”, Lavdrimi përgjigjet “po”. Drini i thotë “Drejtori i Arsimit në Telefon...”, Lavdrimi i thotë “Urdhëro”. Drini e pyet “Lavdrim, a ke votu...?” dhe Lavdrimi përgjigjet “Jo akoma”. Drini e pyet “po pse mor Lavdrim nuk ke votu akoma...?”, Lavdrimi përgjigjet “skam votu se thashë të lirohet njëherë rradha”. Drini i thotë “Lavdrim, mos kemi llafë, votat i dua haptas atje, mos kemi llafë mo...” dhe Lavdrimi i përgjigjet “Ça flet mor drejtor, zbëhet llaf ajo punë”. Drini i thotë mos të të pres në besë, 5 vota sa ke t’i dua...” dhe Lavdrimi i thotë “jo jo, pa merak, të paskan sinjalizu gabim”. Drini i thotë “nejse unë këtë llaf po të them pastaj ti e di vetë...” dhe Lavdrimi i thotë “në rregull, në rregull”.

-Nr.613, 614, datë 11.09.2016, komunikim ndërmjet Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr.celular 068 26 50 139 dhe shtetasit shtetasit Hidajet Dushku (dyshohet mësues në Sllovë), përdorues i nr.celular 068 38 81 621; Hidajet Dushku i dërgon SMS Drinit ku i thotë “Drin, unë votat e mia i kam bërë me vidjo, megjithëse kishte vëzhgues nga Tirana. Edhe komisionerëve u thashë kush don ta shikojë votën dhe e ngrita lart. Hidajeti”.

-Nr.837, datë 12.09.2016, bisedë ndërmjet Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr.celular 068 26 50 139 dhe Kryetarit të PS-së Dibër, Afrim Mikli, përdorues i nr.celular 068 45 07 265; Gjatë bisedës, Drini i thotë Afrimit: “kam patur probleme për ato lëvizjet që kemi bërë në fushatë...”.Drini i thotë gjithashtu se “për atë rastin që kam tek gjimnazi i Kastriotit që e lamë për të heq Kimete Mazarin dhe të sjellim atë Arben Pulën, më ka marrë Qamil Lata dhe më thotë Kimete Mazari nuk do lëvize pasi e kam timen”.Drini e pyet Afrimin “ç’farë të bëjmë se nuk po e marr vesh?” dhe Afrimi i përgjigjet “tani e kemi mbarë atë muhabet...”.

-Nr.1129, datë 15.09.2016, bisedë ndërmjet Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr.celular 068 26 50 139 dhe Administratorit të Njesisë Administrative Fushë Çidhën, Dik Spata, përdorues i nr.celular 068 32 18 268; Bashkëbiseduesit diskutojnë për vende pune në shkollën e fshatit Bllicë. Ndër të tjera Drini i thotë shtetasit Dik Spata se e kanë urdhëruar ato të PDIU-së që të vendosë drejtor shtetasin Vullnet Dauti, ndërsa Dika e kundërshton.

-Nr.1456, datë 20.09.2016, bisedë ndërmjet Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr.celular 068 26 50 139 dhe Kryetarit të PS-së Dibër, Afrim Mikli, përdorues i nr.celular 068 45 07 265; Gjatë bisedës, Drini i thotë Afrimit: “nuk kam bërë asnjë lëvizje mor Afrim” dhe Afrimi i thotë “mos bëj edhe ktë javë deri kur të vijmë ne”. Gjithashtu Afrimi i thotë Drinit “hiq nga puna atë Reshat Elezin që është në shkollën e Reçit...”, ndërsa Drini i thotë “e heq mor unë po unë ju pres juve...”. Afrimi i thotë “hiqe, mos më prit fare po qërroje direkt...”, Drini i përgjigjet “po e heq mor unë se është e thjeshtë ajo po puna është se ka një vëlla sekretar asambleje...”. Afrimi i thotë “ai nuk ka punu fare”. Afrimi i thotë gjithashtu “hiq një person me emrin Sadik dhe vendos një person me emrin Përparim” dhe Drini i thotë “po unë juve ju pres”.

-Nr.1502, datë 20.09.2016, bisedë ndërmjet Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr.celular 068 26 50 139 dhe shtetasit Korab/Imer Lala, përdorues i nr.celular 069 20 22 010; Gjatë bisedës, Imeri e pyet Drinin: “ore kush e ka çuar në punë atë nusen e Mezan Merdinit, mësuese në Sohodoll” dhe Drini përgjigjet “kjo në Sohodoll më duket se ka shkuar edukatore”. Imeri i thotë “më duket se ka shkuar mësuese.Po a e di që djali i këtij Mezanit dhe Mezani u nxorri armën njerëzve tonë dhe njerëzit më thonë ç’farë bën që e emëron në punë?!”. Drini i thotë “O Imer, dëgjo tani. Është e vetmja komunë ose Njësi Administrative që kemi bërë ca lëvizje dhe ta kam shkruar edhe me mesazh, me Spartakun, me Arifin, ka qenë prezent edhe Afrimi.Unë nuk kam qenë dakort, por këto lëvizje janë bërë gjatë fushatës”. Imeri e pyet “kush e ka rekomanduar këtë?” dhe Drini përgjigjet se “këtë ma kanë dhënë ato se unë nuk i kam njoft fare, mor fare.Ma kanë dhënë asambleja e atjeshme, këto të PS-së”. Drini i thotë gjithashtu “lidhu njëherë me Spartakun se ta shpjegon” dhe Imeri i thotë “ok”.

-Nr.1505, datë 20.09.2016, bisedë ndërmjet Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr.celular 068 26 50 139 dhe shtetasit Spartak Koltraka, përdorues i nr.celular 067 55 23 777; Gjatë bisedës, Drini i thotë Spartakut “Është bërë e treta herë që më merr në telefon Imeri. Kush është kjo Merdini mor burrë?” dhe Spartaku i thotë “nuk e di hiç kush është kjo Merdini, më mori dhe mua Ymeri”.Drini e pyet “po kush e ka fut në punë këtë mor?”.Drini i thotë “interesohu kush është mor burrë se unë nuk i njoft fare ato që keni fut në punë ju.Ju i keni bërë këto lëvizje dhe faturat i marr unë”.Spartaku i thotë “Arifi më tha duhet të ishte motra jo ajo po kemi bërë gabim”.

-Nr.1513, datë 20.09.2016, bisedë ndërmjet Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr.celular 068 26 50 139 dhe shtetasit Spartak Koltraka, përdorues i nr.celular 067 55 23 777; Gjatë bisedës, Spartaku i kërkon Drinit që të fusë në punë si mësuese shtetasen Dorina Cibaku.Spartaku i thotë “Dorina Cibaku më tha se është vendi bosh tek gjimnazi për bio-kimi” dhe Drini i përgjigjet “po mor po, vendi është bosh, po mua mi kanë bllokuar lëvizjet.Pa ardhur njëherë me u ul këtu ato të Tiranës nuk bëj asnjë lëvizje, kshuqë mos u hap shumë or Spartak se mi kanë blloku.Spartaku i thotë “jo mor po është ajo porosia e tjetër kuj prandaj të mora”.Drini i përgjigjet “po mirë mo se do vijnë edhe ato dhe do ulemi, kto vende nuk i mbaj për vete”.

-Nr.1794, datë 23.09.2016, bisedë ndërmjet Drejtorit të Arsimit Dibër, Drini Gjeci, përdorues i nr.celular 068 26 50 139 dhe Kryetarit të PS-së Dibër, Afrim Mikli, përdorues i

nr.celular 068 45 07 265; Gjatë bisedës, Afrimi i thotë Drinit të Largoje nga puna Reshat Elezin dhe Drini i thotë “dakort”.

-Lidhur me të pandehurin **Hasan Hoti**, përdorues i numrit celular **068 21 87 497**, kanë paraqitur interes për hetimin këto komunikime:

-Nr.72, datë 09.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Lurë, shtetasit Hasan Hoti, përdorues i nr.celular 068 21 87 497 dhe një personi me emrin Ismail, përdorues i nr.celular 068 21 21 524; Gjatë bisedës, Ismaili i thotë Hasanit: “kam fol me njerëzit e Rasim Bucit në Tiranë të cilët do vijnë për në Lurë.A ka noj organizim?” dhe Hasani i përgjigjet “do ketë furgona por nuk i kam plainfikuar këto persona por unë do i planifikoj”. Ismaili i thotë “planifikoi se kam bërë muhabet unë dhe do nisen për Lurë” dhe Hasani i përgjigjet “dakort”.Hasani i thotë gjithashtu “këtyre personave do t’u japim edhe ato gjërat që duhet...”.Personi me emrin Ismail e pyet Hasanin “ndonjë rrugë apo ndonjë gjë a mund t’jua paguajmë...?” dhe Hasani i përgjigjet “rrugën e të gjitha do t’jua paguaj unë dhe kanë edhe diçka tjetër...”. Ismaili i thotë “e marr vesh, e kuptoj por mos bëjmë muhabet në telefon”.

-Nr.172, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Lurë, shtetasit Hasan Hoti, përdorues i nr.celular 068 21 87 497 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 068 42 86 150; Gjatë bisedës, Hasani i thotë bashkëbiseduesit që të gjejë një furgon dhe të sjellë disa votues nga Durrësi në Lurë, pasi naftën do ia paguajë ai (Hasani).Hasani i thotë “bëji 10 veta dhe merri nga Durrësi se furgonin ta paguaj unë”. Gjithashtu i thotë “ti je kryetar grupi dhe ke diçka tjetër...”.

-Nr.173, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Lurë, shtetasit Hasan Hoti, përdorues i nr.celular 068 21 87 497 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 068 32 45 647; Gjatë bisedës, Hasani i thotë bashkëbiseduesit që të shkojë tek një person (i cili nga biseda identifikohet si mësues në Pregjë) dhe ti kërkojë votat në këmbim të një vendimi (nuk sqarohet se për ç’farë bën fjalë ky vendim). Hasani i thotë bashkëbiseduesit që këtij personi ti transmetojë fjalët e tij dhe konkretisht “më tha Hasani, unë të dua votat me filmim dhe nuk do futesh me asnjë njeri por do futesh vetëm dhe do më biesh telefonin... (nënkupton filmimin e votës) dhe më pas si të biesh telefonin e ke vendimin.Nëse nuk bie telefonin nuk të lej as në Pregjë dhe jo me të lënë mësues” dhe personi tjetër i thotë “do të shkoj ta bisedoj”.

-Nr.295, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Lurë, shtetasit Hasan Hoti, përdorues i nr.celular 068 21 87 497 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 068 25 31 510; Gjatë bisedës, bashkëbiseduesi i thotë Hasanit: “jam me Ilirin këtu dhe i thashë për vota.Si e ke skemën për ta faktuar votën’...?” dhe Hasani i përgjigjet “duhet të futet i vetëm me familjen e vet dhe ta filmojë votën me telefon”. Personi i thotë “nuk të lejojnë me telefon tek dhoma e votimit por nëse prek Kuranin Iliri a e beson?” dhe Hasani i përgjigjet “në rregull”. Personi i thotë “lekët kur të

mbarojmë...” dhe Hasani i përgjigjet “lekët sonte”. Personi i thotë Hasanit “nuk ka problem se ia jap unë” dhe Hasani ia kthen “sonte të jap lekët o shoku im”.

-Nr.295, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Lurë, shtetasit Hasan Hoti, përdorues i nr.celular 068 21 87 497 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 068 25 31 510; Gjatë bisedës, bashkëbiseduesi i thotë Hasanit “Xheladin Gjoçi më mori në telefon dhe më tha a ke vend për dy gocat por me lekë...?” dhe Hasani i përgjigjet “mirë, merre merre...”.

-Nr.482, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Lurë, shtetasit Hasan Hoti, përdorues i nr.celular 068 21 87 497 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 068 68 28 515; Gjatë bisedës, Hasani i thotë bashkëbiseduesit: “më dëgjo mua tani, si mik si të kam, deklaroje votën, bëje me filmim se mi kërkojnë me urgjencë” dhe personi i përgjigjet “pa merak, aty më ke mua”.

-Nr.483, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Lurë, shtetasit Hasan Hoti, përdorues i nr.celular 068 21 87 497 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 068 23 41 446; Gjatë bisedës, Hasani i thotë bashkëbiseduesit: “shife se janë piketuar edhe nja dy persona këtu, mbaje atë porosinë që ta kam dhënë” dhe personi i përgjigjet “më vjen keq po unë jua kam shkatërru llafet edhe me ty edhe me Melaimin”.Hasani i thotë “do të votoni aty dhe ti mbaje me kamer, ndize kamerën dhe ajo kamera nuk bën shkrepte sepse kshu ma kërkojnë se ka ik edhe tjetri...” dhe personi i përgjigjet “po mirë, mos e vrit mendjen”.

-Nr.543, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Lurë, shtetasit Hasan Hoti, përdorues i nr.celular 068 21 87 497 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 069 53 32 610; Gjatë bisedës, bashkëbiseduesi i thotë Hasanit “tre vota ke Lutfiu i ke të sigurt” dhe Hasani i përgjigjet “ok, është Femiun ...” (nënkupton se duhet të lidhet Femiun).Personi i thotë “nëse nuk ke besim tek ato ti kam borxh unë” dhe Hasani i përgjigjet “jo or daj, ti bëje me foto”. Personi i thotë “në daç fut njeri në, në daç fitoi në vend” dhe Hasani i thotë “si të doni ose të marrë njeri ose me foto”.Personi i thotë “si të duash ti?”.Personi i thotë gjithashtu Hasanit “kur t’më takosh mua ...?” dhe Hasani i përgjigjet “vjen Femiun poshtë...” (duke nënkuptuar se ka lënë Femiun të merret me ato).

-Nr.623, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Lurë, shtetasit Hasan Hoti, përdorues i nr.celular 068 21 87 497 dhe shtetases Muçe Skana, përdoruese e nr.celular 068 27 83 987; Gjatë bisedës, Hasani i thotë Muçes që të shkoje të votojë. Muçja i thotë “unë bashkë me plakun do votoj për ty, ndërsa të tjerët Mandi e nusja janë për tjetrin”.Hasani i thotë “ne i kemi bërë njëher llafet, duhet t’më kishe thënë” dhe Muçja i përgjigjet “do të kisha thënë po mu prish telefoni, se këto me 100 mijë lekë nuk janë.Këto paret tuja le të rrijnë”. Hasani e pyet “si the ti me 100 mijë lekë?!Po kush të ka dhënë më tepër?!” dhe Muçja i përgjigjet “këto vallaj kan shpërnda nga 200 mijë për

votë”.Hasani i thotë “unë i dua të deklaruara votat pra” dhe Muçja i përgjigjet “4 vota i ke prej nesh, unë dhe plaku dhe Blerimi me grua”.

-Nr.705, 718, datë 11.09.2016, komunikim me SMS ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Lurë, shtetasit Hasan Hoti, përdorues i nr.celular 068 21 87 497 dhe Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër Robert Aga, përdoruese e nr.celular 068 20 44 141; Gjatë komunikimit me SMS, Hasani i thotë Robertit “Bllokona Rifat Nezhën se është me babën e tij” dhe Roberti i përgjigjet “Fola tani dhe do jetë me ne”.

-Nr.730, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Lurë, shtetasit Hasan Hoti, përdorues i nr.celular 068 21 87 497 dhe një personi me emrin Femi, përdoruese e nr.celular 068 62 04 429; Gjatë bisedës, Hasani i thotë Femiut: “a del pak aty se po vjen ai djali i Rasim Bucit...” dhe Femi i përgjigjet “po nxjerr Eduartin”. Femi e pyet Hasanin “a 30 mijë lekë ti jap...?” dhe Hasani i përgjigjet “po mor burr”.

-Nr.737, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Lurë, shtetasit Hasan Hoti, përdorues i nr.celular 068 21 87 497 dhe një personi me emrin Femi, përdoruese e nr.celular 068 62 04 429; Gjatë bisedës, Femi i thotë Hasanit: “jam tek dera e qendrës së votimit por kanë vënë roje” dhe Hasani i thotë “e ke atë djalit aty”. Femi i thotë “thuaji atij djalit do ia jap unë por tani nuk mundem se kanë vënë roje...” dhe Hasani i përgjigjet “mirë”.

-Nr.739, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Lurë, shtetasit Hasan Hoti, përdorues i nr.celular 068 21 87 497 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 069 53 32 610; Gjatë bisedës, Hasani i thotë bashkëbiseduesit: “jepja paret tuja atij dhe të shkoje të votojë dhe hajde pasdite të ti jap paret në Lurë se janë tu u ngatërru atje dhe nuk dalin dot as Femi dhe As Eduarti, kanë vu roje atje poshtë dhe i shofin njerëzit nga shkojnë”.Hasani i thotë gjithashtu “jepja paret tuja dhe hajde të të jap 300 mijë lekshin në darkë” dhe bashkëbiseduesi i përgjigjet “në rregull”.

-Nr.767, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Lurë, shtetasit Hasan Hoti, përdorues i nr.celular 068 21 87 497 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 069 53 32 610; Gjatë bisedës, bashkëbiseduesi i thotë Hasanit: “Nuk bëhet, duan 150 ato...” dhe Hasani përgjigjet “janë shumë po hë se do ta marrë Bert Aga”.

-Nr.957, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Lurë, shtetasit Hasan Hoti, përdorues i nr.celular 068 21 87 497 dhe një personi me emrin Qamil, përdorues i nr.celular 068 60 53 309; Gjatë bisedës, Hasani i thotë Qamilit: “dëgjom me vëmendje.Do të ta ndaloj çentralin me vendim të këshillit bashkiak.Merre Bashkimin në telefon, i thuaji merr çunin e Mitatit, të votojë çuni i Mitatit me nënën e vet”. Qamili i përgjigjet “mirë”. Hasani i thotë “nuk e çoi e nuk votoi me çunin e Mitatit, ta harrosh. Hebibin e Bashkimin do ti mbaj me hu dhe nuk kan me hy aty tek dajat e mi” dhe Qamili i përgjigjet “mirë”.

-Lidhur me të pandehurin **Nuri Meda**, përdorues i numrit celular **068 34 96 073**, kanë paraqitur interes për hetimin këto komunikime:

Nr.115, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe shtetasit Nderim Kullaku, përdorues i nr.celular 066 52 77 552, i cili voton në Dibër por jeton në Durrës; Gjatë bisedës, Nuriu i thotë Nderimit “hajde votoni”. Nderimi e pyet “ç’farë përfitoj nëse vij...?” dhe Nuriu i përgjigjet “rrugën vajtje-ardhje do jua paguaj dhe gjithashtu dhe noj gjë, noj kafe do të ta jap... edhe hajde na jep votat”.

-Nr.159, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe personit me emrin Halim, përdorues i nr.celular 068 47 90 574; Gjatë bisedës, Halimi i thotë Nuriut “ç’farë do bëjmë me këtë Halil Kabën se më ka mbetur var gjithë ditën...?A e sollëm që atje vetë i pesti...?A ke bërë llaf me të a jo...?” dhe Nuriu ia kthen “po të bëjmë llaf...”. Halimi e pyet Nuriun “Ç’farë të them ...?” dhe Nuriu ia kthen “hë se do e ndreqim..., do ta rregulloj unë se do shkoj njëherë tek Imeri...”.

-Nr.165, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe personit me emrin Halim, përdorues i nr.celular 068 47 90 574; Biseda rreth tyre zhvillohet në lidhje me shtetasin Halil Kaba. Gjatë bisedës, Nuriu i thotë Halimit: “thua ju se e ke çdo gjë tek Nuriu, thuaj do të japë Nuriu 200 mijë lekë”. Halimi ia kthen “për 200 mijë lekë nuk gënjehet ai se ka 7 vota ai”. Nuriu i thotë “eh mor Halim tani”. Halimi i thotë “or dajë, po ju më thatë merre në telefon që të vije” dhe Nuriu i përgjigjet “thua ju Imerit se të shkatërro (sqaron) ai...”.

-Nr.166, 167, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe Kryetarit të PS-së Dibër, Afrim Mikli, përdorues i nr.celular 068 45 07 265; Gjatë bisedës, Nuriu i thotë Afrimit: “është një Halil Kaba që ka 8 vota dhe unë i thashë që nja 200 mijë do të ti jap po ai do më shumë. Ç’farë ti themi...?” dhe Afrimi i revoltuar që Nuriu këto muhabetë ia bën në telefon i përgjigjet “nuk merremi me ato punë, ça është ky muhabet...”. Nuriu i thotë “ik se bëj llaf vetë dhe ia mbyll telefonin”. Afrimi e telefonon sërish Nuriun dhe i thotë “ku je mor burrë përse e mbyll telefonin...?! Hajde...” (duke nënkuptuar që të vije të merren vesh për Halil Kabën) dhe Nuriu ia kthen “ik ti të bëj muhabet unë...”.

-Nr.170, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe shtetasit Elio Lala, përdorues i nr.celular 069 37 51 007; Gjatë bisedës, Elio i thotë Nuriut: “jam nipi i imërit, më ka prurë për një porosi...” dhe Nuriu i përgjigjet “jam tek doktori i syve”. Elio i thotë “ja se po vij aty”.

-Nr.381, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe një personi me emrin Halim, përdorues i nr.celular 068 47 90 574; Nuriu i thotë Halimit: “A ia ke dhënë Halil Kabës ato lekë mor burrë se më çmende...?” dhe Halimi i përgjigjet “ia kam dhënë mor burrë, a nuk ke besim tek unë apo të të bëj be në fëmijë”. Nuriu ia kthen “lëre tani mos bëj be por më tha ndryshe Ylli Zebi”.

-Nr.178, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 068 29 25 049; Gjatë bisedës, bashkëbiseduesi i thotë Nuriut: “jam takuar me Nexhmi Trukën”. Nuriu e pyet “ç’farë thotë Nexhmi?”, personi përgjigjet “jo, mirë, po ta kishit parë pak ...” (duke nënkuptuar që ti japin diçka). Nuriu ia kthen “çdo gjë e ke me Nuriun, të shikon Nuriu...”. Nuriu gjithashtu i thotë bashkëbiseduesit “thuaqi Nexhmiut që shko e takoje tek shpia Nuriun...”.

-Nr.230, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe një personi me emrin Banush, përdorues i nr.celular 068 67 70 930; Gjatë bisedës, Nuriu i thotë Banushit: “Takoje Samiun se më duket se tre vota ka, dhe nja 100 mijë lekë thuaqi i ka Nuriu në xhep...”. Banushi i përgjigjet “nuk është aty ai, është gruaja me nusen e me djalin” dhe Nuriu ia kthen “po mirë, bëj llaf me gruan dhe hajde në orën 2 te shtabi dhe bisedojmë bashkë...”.

-Nr.318, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe shtetasit Mir Hakorja, përdorues i nr.celular 068 30 95 990; Gjatë bisedës, Miri i thotë Nuriut: “tek ai vendi që mi dhe mua ato... vetëm dy vota ka ai. Ça të bëj?”. Nuriu e pyet “sa të dhashë për atë...?”, Miri i përgjigjet “një...”. Nuriu i thotë “atëherë jepi 80, njëzetëshen mbaje vetë...”.

-Nr.320, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe shtetasit Mir Hakorja, përdorues i nr.celular 068 30 95 990; Gjatë bisedës, Nuriu i kërkon sqarime shtetasit Mir Hakorja lidhur me bisedën e mësipërme nr.318. Nuriu i thotë Miri: “djalin e nuk e ka aty apo nuk na e jep votën...?” dhe Miri i përgjigjet “djalin e ka aty po nusen e djalit nuk e bind dot”. Nuriu i thotë “thuaqi që të na japë edhe votën e nuses, ndryshe thuaqi mos i kërko asistencë Nuriut” dhe Miri i përgjigjet “ia thashë këtë gjë”. Nuriu i thotë “mirë faleminderit”.

-Nr.375, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe shtetasit Mir Hakorja, përdorues i nr.celular 068 30 95 990; Gjatë bisedës, Miri i thotë Nuriut: “Samiu nuk është këtu po vetëm nusja me djalin...” dhe Nuriu ia kthen “jepja nuses me djalin, po thuaq të votojnë të paktën...”. Miri i thotë “po mor po”.

-Nr.326, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 068 62 79 134; Gjatë bisedës, Nuriu i thotë bashkëbiseduesit “Mendim Merdini, Mahmudie Merdini dhe Merdini (emri nuk kuptohet)...”, personi tjetër i përgjigjet “ja ta marr në telefon atë të qendrës, të kthej përgjigje për dy minuta”. Personi e pyet Nuriun “a kanë ardhur?” dhe Nuriu përgjigjet “këto njerëz janë në Tiranë, në qoftëse e ke parasysh tani ti..., vijnë për ne këto, a më kupton....?” (duke nënkuptuar që duan diçka) dhe personi tjetër përgjigjet “u kry bac, ja të kthej përgjigje unë...”.

-Nr.331, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe një personi të pa identifikuar, përdorues i nr.celular 068 62 79 134; Gjatë bisedës, lidhur me personat me mbiemër Merdini, bashkëbiseduesi i thotë Nuriut: “Nisi Nure, nisi ktej...”. Nuriu i thotë “a e merr vesh llafin se ça bëhet ...?” (duke nënkuptuar se ato duan diçka që të vijnë nga Tirana) dhe personi tjetër i përgjigjet “e marr vesh, e marr, po thuaji të lidhen me Lorin dhe të vijnë se është e mbaruar kjo punë”. Gjithashtu personi i thotë Nuriut “sa vetë të jenë të vijnë, po vetëm të shkojnë të takojnë Lorin”. Nuriu e pyet “cilin Lor...?” dhe personi i përgjigjet “Lorenc Cibakun”.

-Nr.408, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe një personi me emrin Luan, përdorues i nr.celular 068 39 48 889; Gjatë bisedës, Luani i thotë Nuriut: “me atë Kullakun a fole? Me ato fëmijët e Pllumit...?” dhe Nuriu i thotë “kam fol me to dhe u kam thënë hajdeni se do rregullohem...”. Luani i thotë “më mori Përparimi dhe më tha na ka marrë Nuriu...” dhe Nuriu i përgjigjet “po do ti marr mor burrë po ato kërkojnë shumë. Unë i thashë ti jap nja 200 mijë po ato nuk e di a 500 mijë a 600 mijë kërkojnë”. Luani i thotë t’u japësh 200 mijë dhe rrugën, ashtu e kam biseduar me Përparimin” dhe Nuriu i përgjigjet “or 200 mijë edhe rrugën do jua jap, noj naftë noj gjë...”.

-Nr.415, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe një personi të paidentifikuar, i cili prezantohet si kushuri i Nuriut, përdorues i nr.celular 068 47 86 987; Gjatë bisedës, bashkëbiseduesi i thotë Nuriut: “më kapi djali i Himi edhe mua edhe djalin, do të ti lëshoj kshu tha...” dhe Nuriu ia kthen “jepi shtru ti...(nënkupton jepi votat hapur) dhe hyri garant ti se ti jap unë... (nënkupton dhënien e parave).

-Nr.419, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe shtetasit Sajmir Krosi, përdorues i nr.celular 069 36 68 876; Gjatë bisedës, Sajmiri i thotë Nuriut: “atë porosinë s’ma kanë mbaruar...” dhe Nuriu i thotë “ja të bëj një telefon dhe të kthej përgjigje”.

-Nr.420, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe një personin me emrin Zenel, përdorues i nr.celular 068 23 10 173; Gjatë bisedës, Nuriu i thotë Zenelit: “ai Sajmir Krosi më merr në telefon dhe thotë që nuk i ka shku porosia...” dhe Zeneli ia kthen “ia ka dhënë gruas së vet...”.

-Nr.421, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe shtetasit Sajmir Krosi, përdorues i nr.celular 069 36 68 876; Gjatë bisedës, Nuriu i kthen përgjigje Sajmiri ku i thotë: “foli në telefon dhe ai më tha se porosia ka shkuar dhe ia ka çu gruaja e tij, por megjithatë nëse nuk ka shku do merremi vesh bashkë pas datës 12...” dhe Sajmiri i thotë “mirë...”.

-Nr.427, datë 10.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe një shtetasje me emrin

Burbuqe, përdorues e nr.celular 068 52 04 622; Gjatë bisedës, Nuriu i thotë Burbuqes: “ato porositë që ti pata dhënë me listë a u kan shkuar nëpër shpia të gjithëve...?” dhe Burbuqja i përgjigjet “vetëm Demes..., Veliut nuk i kanë shkuar pasi rrinin njerëzit andej rrotull...”.

-Nr.497, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe një personi me emrin Gazmir, përdorues e nr.celular 068 38 32 257; Gjatë bisedës, Gazmiri i thotë Nuriut: “Ai djali i atij Xharrit, ai Endër Xharri kanë ardh. A do iu japësh noj lek atyre se nuk kanë për të të ardh të të votojnë ato, gruaja e Shefik Xharrit” dhe Nuriu përgjigjet “po mor të thashë, po po mor burrë u kam thënë, ça më thoni kshu...”. Nuriu i thotë Gazmiri “a kanë ardh prej Durrësi se vij e bisedojmë bashkë...”.

-Nr.531, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe një personi me emrin Renato, përdorues e nr.celular 069 55 30 171; Gjatë bisedës, Renato i thotë Nuriut: “Subiu mi pat dhënë 100 mijë prej teje” dhe Nuriu i thotë “shshsh... mos bën llaf se do takohemi bashkë”.

-Nr.593, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe një personi me emrin Gazmir, përdorues e nr.celular 068 38 32 257; Gjatë bisedës, Gazmiri i thotë Nuriut: “si do ia bëjmë me këtë Njazi Domazetin or burr i dheut se ky djali më është afruar dhe thotë due një gjë” dhe Nuriu ia kthen “po ti japim mor nja 100 mijë lekë thuaji, po atë e ka marrë përsipër Doshi fjala”.

-Nr.596, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe një personi me emrin Doshi, përdorues e nr.celular 068 20 02 333; Gjatë bisedës, Nuriu i thotë Doshit: “merre mor njëherë atë Njazi Domazetin dhe thuaji ça halli ke e ke tek unë mor thuaji, e ke çdo gjë me mua, çke me atë punë thuaji ti”.

-Nr.607, 608, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe një personi i cili prezantohet si nipi i Zeqir Domazetit, përdorues e nr.celular 068 50 07 951; Gjatë bisedës, bashkëbiseduesi i thotë Nuriut: “unë kam ardhur bashkë më vëlla që atje me lekë borxh dhe Agimi tallet me mua”. Personi i thotë Nuriut “Agimi më ka dhënë vetëm 10 mijë lekë dhe ai nuk i kishte marrë”. Nuriu i përgjigjet “nëse qëndron edhe nesër, do të të shikoj, do të ti jap vetë nga xhepi...”.

-Nr.617, datë 11.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe një personi me emrin Selami, përdorues e nr.celular 068 58 63 814; Gjatë bisedës, Nuriu i thotë Selamiut: “me ato problemet a i keni mbaru gjitha vendet...?” dhe Selamiu i përgjigjet “vetëm Veliut nuk i kam dhënë gjë se do shkoje të votoje njëherë se ska shku akoma...”. Nuriu e pyet “po këtyre tjerëve a u keni dhënë këtyre tjerëve, ke mbaru punë...?” dhe Selamiu i përgjigjet “krejt tjerët i kam mbaru...”. Nuriu e pyet “po Naim kullakun ke mbaru...?” dhe Selamiu i përgjigjet “po, po, po me Qil e me Fadil e me ato...”.

-Nr.620, 621, datë 11.09.2016, komunikim me SMS ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe shtetasit Halil Avelli, përdorues e nr.celular 068 25 06 956; Gjatë komunikimit me SMS, Halil Avelli i shkruan Nuriut: “O Nure jam Halil Avelli, a të shkoj të votoj a jo...?.Do ti tregoj fotot se kë kam votu.Kthe përgjigjie, po a jo...?” dhe Nuriu i përgjigjet me sms “shko se me mua ke punë...”.

-Nr.1024, datë 13.09.2016, komunikim me SMS ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe shtetasit Halil Avelli, përdorues e nr.celular 068 25 06 956; Halili i dërgon Nuriut SMS, ku i thotë: “Halil Avelli jam.Me llaf burrash më the se do takohemi...”.

-Nr.845, datë 12.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe një personi me emrin Agim, përdorues e nr.celular 068 30 26 424; Gjatë bisedës, Nuriu i thotë Agimit: “e kemi lajmëru atë djalin që atje dhe ai më tha vetëm 10 mijë lekë më dha Agimi...” dhe Agimi i përgjigjet “jo i dhashë 30 mijë po ai nuk i mori...”.Nuriu i thotë “a ti japim 30 ti e 30 unë...?” dhe Agimi i përgjigjet “po”.

-Nr.1335, datë 15.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe Administratorit të Njesisë Administrative Muhurr, shtetasit Ylli Mikli, përdorues e nr.celular 068 44 22 907; Gjatë bisedës, Ylli e pyet Nuriun: “për kë ka votuar Kujtim Margjoni...?” dhe Nuriu i përgjigjet “kanë votuar djathtas”. Ylli i thotë “shkriji fare, mprefe atë lapsin e kuq dhe bjeru kokës...” dhe Nuriu ia kthen “i kam heq, u kam vu vizën e kuqe...”.

-Nr.1758, 1760, 1779, 1781, 1784 dhe 1830, datë 21.09.2016, bisedë ndërmjet Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, shtetasit Nuri Meda, përdorues i nr.celular 068 34 96 073 dhe një vartësje të tij, Adelina Çenga, punonjëse e Njesisë Administrative Tomin, përdoruese e nr.celular 069 36 92 333;

Gjatë bisedave, shtetasi Nuri Meda, në atë kohë me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Tomin, bashkia Dibër, urdhëron vartësen e tij, Adelina Çenga, punonjëse e Njesisë Administrative Tomin, që të largojë nga skema e ndihmës ekonomike persona të cilët sipas tij nuk e kanë mbështetur politikisht, në zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Dibër, të zhvilluara me datë 11 shtator 2016, ku shtetasi Nuri Meda ka mbështetur kandidatin e Aleancës Për Shqipërinë Evropiane, (ASHE).

Nga bisedat e përgjuara, Administratori Nuri Meda, urdhëron vartësen e tij Adelina Çenga, që në **fshatin Zdojan**, të largojë nga skema e ndihmës ekonomike shtetasit **1-Neritan Vojka, 2-Mensur Selxhaferri, 3-Islam Kola, 4-Dashamir Tuka, 5-Sinan Sefullaj, 6-Ardian Vojka, 7-Adrian Mirku, 8-Dilaver Driza, 9-Nderim Reçi, 10-Edmond Degjoni, 11-Nexhat Sefullaj dhe 12-Vladimir Ashiku**, të cilët sipas tij nuk e kishin mbështetur politikisht në zgjedhjet e datës 11 shtator 2016.

Nga bisedat e përgjuara, Administratori Nuri Meda, urdhëron vartësen e tij Adelina Çenga, që në **fshatin Ushtelenxë**, të largojë nga skema e ndihmës ekonomike shtetasit **1-Shefik Kica, 2-Asllan Hysa, 3-Artur Kazia, 4-Genci Papuli, 5-Përparim Sallahi, 6-Muharem Zebi,**

7-Arben Doçi, 8-Lazim Zebe, 9-Luan Cena, 10-Shuaip Kica, 11-Kujtim Kaziu, 12-Muiz Doçi, 13-Ali Sallahi, 14-Qazim Doçi dhe 15-Lorenc Zebe, të cilët sipas tij nuk e kishin mbështetur politikisht në zgjedhjet e datës 11 shtator 2016.

Nga bisedat e përgjuara, Administratori Nuri Meda, urdhëron vartësen e tij Adelina Çenga, që në **fshatën Pilafe**, të largojë nga skema e ndihmës ekonomike shtetasit **1-Dashamir Çenga**, **2-Nazmi Çenga**, **3-Shyqiri Çenga**, **4-Kadri Muda**, **5-Shkëlqim Muda**, **6-Rustan Çenga**, **7-Fabio Muda**, **8-Qazim Muda**, **9-Vehap Muda**, **10-Behar Kaba** dhe **11-Hekuran Kaba**, të cilët sipas tij nuk e kishin mbështetur politikisht në zgjedhjet e datës 11 shtator 2016.

Nga bisedat e përgjuara, Administratori Nuri Meda, urdhëron vartësen e tij Adelina Çenga, që në **fshatën Zimur**, të largojë nga skema e ndihmës ekonomike shtetasin **1-Mahmut Kamberi**, pasi sipas tij ky person ishte vëllai i shtetasit Bedri Kamberi, i cili nuk e kishte mbështetur politikisht në zgjedhjet e datës 11 shtator 2016.

IV. ANALIZA JURIDIKE E FAKTEVE.

-Lidhur me **të pandehurin Robert Aga**, i cili në momentin e realizimit të veprës penale ka mbajtur detyrën e Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, janë provuar këto episode të shpërdorimit të detyrës:

-Në episodin e evidentuar në bisedat e përgjuara me **nr.210, datë 09.09.2016**, dhe **nr.213, datë 09.09.2016**, të subjektit **Arben Keshi**, i pandehuri Robert Aga, në atë kohë me detyrë Shef i Komisarariatit të Policisë Dibër, vendos në dispozicion të mbështetësve të kandidatit të ASHE-së, shërbimet policore.

Konkretisht gjatë bisedave të përgjuara, Shefi i Komisarariatit të Policisë Dibër, Robert Aga, i thotë shtetasit Arben Keshi, i identifikuar si mbështetës i kandidatit të ASHE-së: **“kam nis ca shërbime policie atje, të FNSH-së një dy grupe që bëjnë patrullime, bëjnë gjërat..., porositi që janë në ndihmë të tyre...”** dhe Arbeni i përgjigjet **“në rregull, dakort, rrofsh...”**. Roberti i thotë **“do ti mbaj të dy aty deri nesër mbrëma gjithë natën, që të paktën njerëzit tonë të ndjehen të sigurtë të shkojnë të votojnë.Bëjua të qartë...”** dhe Arbeni i përgjigjet **“po po”**.

Menjëherë pas komunikimit me Shefin e Komisarariatit të Policisë Dibër Robert Aga, shtetasi Arben Keshi, telefonon një person, përdorues i nr.celular 069 29 20 162, të cilit i thotë: **“shif ki parasysh ato të tujt, ta dinë ato se janë t’u ardh një dy grupe të FNSH-së, që do patrullojnë nëpër Maqellarë, po ta dinë makinat tona...”** dhe personi tjetër i përgjigjet **“mirë, po a ti heqin ato do druna, do gjëja... ç’farë kanë...”** dhe Beni i thotë **“po po, ti heqin, nuk do jetë e nevojshme se do patrullojnë ato...”** dhe personi tjetër i përgjigjet **“në rregull, pa merak...”**.

Në këtë rast, veprimet e të pandehurit Robert Aga, vijnë në kundërshtim me **nenin 5, pika “dh”** dhe **nenin 90, pika “b”**, të ligjit nr.108/2014, **“Për Policinë e Shtetit”**, pasi është shkelur një ndër parimet bazë, në të cilat udhëhiqet veprimtaria e Policisë së Shtetit dhe konkretisht parimi i **“paanshmërisë politike”** dhe gjithashtu është shkelur edhe kufizimi i sanksionuar me ligj që **punonjësit të policisë i ndalohet kategorikisht të mbështesë fushatën e një force politike**.

Veprimet e kundërligjshme të personit nën hetim Robert Aga, të kryera me dashje dhe me qëllim mbështetjen e një force politike, përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës me

pasojë dëmtimin e interesave të institucionit të policisë së shtetit por edhe të shtetasve të cilët nuk kanë marrë një shërbim të paanshëm gjatë procesit zgjedhor.

-Në episodin e evidentuar në komunikimet e përgjuara me **nr.Nr.274, 275, 279, 291, datë 11.09.2016**, i pandehuri Robert Aga, në atë kohë me detyrë Shef i Komisarariatit të Policisë Dibër, vendos funksionin e tij policor, në dispozicion të mbështetësve të kandidatit të ASHE-së.

Konkretisht, gjatë komunikimeve të përgjuara, personi me emrin Genti, përdorues i nr.celular 068 80 43 330, i cili identifikohet si mbështetës i kandidatit të ASHE-së, i thotë Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, Robert Aga: *“Të lutem më kthe përgjigjie, kanë filluar me i ndal furgonat në Tiranë, të lutem kije parasysh një furgon IVECO i Skënder Elezaj, është plot me njërëzit tanë, mos ta ndalin.... Si të duhet targa ta dërgoj... Respekto Genti”* dhe Roberti i kthen SMS ku i thotë *“Ma dërgo...”* dhe personi me emrin Gent i kthen SMS *“AA 027 LI”*. Vendosja nga i pandehuri Robert Aga, e funksionit të tij policor, në mbështetje të një force të caktuar politike, është një veprim i cili vjen në kundërshtim me **nenin 5, pika “dh”** dhe **nenin 90, pika “b”, të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”**, pasi në këtë rast është shkelur një ndër parimet bazë, në të cilat udhëhiqet veprimtaria e Policisë së Shtetit, ai i **“paanshmërisë politike”** dhe gjithashtu është shkelur edhe kufizimi i sanksionuar me ligj që **punonjësit të policisë i ndalohet kategorikisht të mbështesë fushatën e një force politike**. Veprimi i kryer me dashje dhe me qëllim mbështetje të një force të caktuar politike, përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës me pasojë dëmtimin e interesave të institucionit të policisë së shtetit por edhe të shtetasve të cilët nuk kanë marrë një shërbim të paanshëm gjatë procesit zgjedhor.

-Në episodin e evidentuar në bisedën e përgjuar me **nr.419, datë 11.09.2016**, i pandehuri Robert Aga, në atë kohë me detyrë Shef i Komisarariatit të Policisë Dibër, nëpërmjet formave të paligjshme, vihet në mbështetje të kandidatit të ASHE-së.

Gjatë bisedës së përgjuar, Shefi i Komisarariatit të Policisë Dibër, Robert Aga, i thotë një personi tjetër, përdorues i nr.celular 068 41 56 383: *“më bjer numrin e Reshatit pasi nuk e kam dhe gjithashtu premtoi ndonjë gjë... se më tha tezen tënde nuk e ke parë hiç...”* dhe personi tjetër i thotë *“mirë, mirë...”*.

Mbështetja e një force të caktuar politike nga Shefi i Komisarariatit të Policisë Dibër Robert Aga, për më tepër edhe në formë të paligjshme, vjen në kundërshtim me **nenin 4, pika “2”** dhe **nenin 90, pika “b”, të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”**, pasi në këtë rast, është shkelur statusi i Policisë së Shtetit, **pra veprimtaria e depolitizuar** e shërbimit policor dhe gjithashtu edhe kufizimi i sanksionuar me ligj që **punonjësit të policisë i ndalohet kategorikisht të mbështesë fushatën e një force politike**.

Veprimi i kryer me dashje dhe me qëllim mbështetjen e një force të caktuar politike, përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës me pasojë dëmtimin e interesave të institucionit të policisë së shtetit.

-Në episodin e evidentuar në bisedat e përgjuara me **nr.421, 422 dhe 435, datë 11.09.2016**, i pandehuri Robert Aga, në atë kohë me detyrë Shef i Komisarariatit të Policisë Dibër, nëpërmjet formave të paligjshme (ndërhyrjeve), vihet në mbështetje të kandidatit të ASHE-së.

Gjatë bisedave të përgjuara, rezulton se Shefi i Komisarariatit të Policisë Dibër, me sugjerimin e Administratorit të Njesisë Administrative Lurë, shtetasit Hasan Hoti, ndërhyr tek shtetasi Rufat Nezha, duke ndikuar tek ky i fundit që të votojë pro kandidatit të ASHE-së.

Pasi Rufat Nezha e siguron që do votojë pro tyre, personi nën hetim i përgjigjet *“Rrofsh, t’kam mik të mirë, do të ta shpërblej vëllai jot, zere se m’ke vëlla, ke unë e ke derën e hapur gjithmonë” dhe Rifati i thotë “shumë shumë, faleminderit...”*.

Mbështetja e një force të caktuar politike nga Shefi i Komisarariatit të Policisë Dibër Robert Aga, vjen në kundërshtim me **nenin 4, pika “2” dhe nenin 90, pika “b”, të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”**, pasi në këtë rast, është shkelur statusi i Policisë së Shtetit, **pra veprimtaria e depolitizuar** e shërbimit policor dhe gjithashtu edhe kufizimi i sanksionuar me ligj që **punonjësit të policisë i ndalohet kategorikisht të mbështesë fushatën e një force politike**.

Veprimi i kryer me dashje dhe me qëllim mbështetjen e një force të caktuar politike, përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës me pasojë dëmtimin e interesave të institucionit të policisë së shtetit.

-Në episodin e evidentuar në bisedën e përgjuar me **nr.436, datë 11.09.2016**, i pandehuri Robert Aga, në atë kohë me detyrë Shef i Komisarariatit të Policisë Dibër, nëpërmjet formave të paligjshme (ndërhyrjeve), vihet në mbështetje të kandidatit të ASHE-së.

Gjatë bisedës së përgjuar, rezulton se Shefi i Komisarariatit të Policisë Dibër, Robert Aga, ndërhyr tek një person, përdorues i nr.celular 068 26 90 563, duke i thënë: *“Shko njëherë mbështilli çato njerëz të shkojnë të votojnë, shpirt të kam...”* dhe personi i përgjigjet *“të rrish pa merak, top i ke”*. Roberti i thotë përsëri *“shpirt të kam”* dhe sërish bashkëbiseduesi ia kthen *“Top i ke”*. Roberti i thotë *“je shumë i mirë”*.

Mbështetja e një force të caktuar politike nga Shefi i Komisarariatit të Policisë Dibër Robert Aga, vjen në kundërshtim me **nenin 4, pika “2” dhe nenin 90, pika “b”, të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”**, pasi në këtë rast, është shkelur statusi i Policisë së Shtetit, **pra veprimtaria e depolitizuar** e shërbimit policor dhe gjithashtu edhe kufizimi i sanksionuar me ligj që **punonjësit të policisë i ndalohet kategorikisht të mbështesë fushatën e një force politike**.

Veprimi i kryer me dashje dhe me qëllim mbështetjen e një force të caktuar politike, përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës me pasojë dëmtimin e interesave të institucionit të policisë së shtetit.

-Në episodin e evidentuar në komunikimet e përgjuara me **nr.493, 515 dhe 544, datë 11.09.2016**, i pandehuri Robert Aga, në atë kohë me detyrë Shef i Komisarariatit të Policisë Dibër, nëpërmjet formave të paligjshme (ndërhyrjeve), vihet në mbështetje të kandidatit të ASHE-së.

Gjatë komunikimeve të përgjuara, rezulton se Shefi i Komisarariatit të Policisë Dibër, Robert Aga, me sugjerimin e Administratorit të Njesisë Administrative Lurë, shtetasit Hasan Hoti, ndërhyr tek shtetasi Lutfi Buci, duke ndikuar tek ky i fundit që të votojë pro kandidatit të ASHE-së, dhe Lufti Buci i përgjigjet: *“Përhëndetje, që të jesh i sigurtë ti, a do ti boj votat me filmim a me dëshmitar.Lutfi Buci”* dhe Robert Aga ia kthen *“Me dëshmitar apo me filmim unë besoj tek miku im Lutfi Buci...”*.

Mbështetja e një force të caktuar politike nga Shefi i Komisarariatit të Policisë Dibër Robert Aga, vjen në kundërshtim me *nenin 4, pika "2"* dhe *nenin 90, pika "b", të ligjit nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit"*, pasi në këtë rast, është shkelur statusi i Policisë së Shtetit, **pra veprimtaria e depolitizuar** e shërbimit policor dhe gjithashtu edhe kufizimi i sanksionuar me ligj që ***punonjësit të policisë i ndalohet kategorikisht të mbështesë fushatën e një force politike.***

Veprimi i kryer me dashje dhe me qëllim mbështetjen e një force të caktuar politike, përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës me pasojë dëmtimin e interesave të institucionit të policisë së shtetit.

-Në episodin e evidentuar në bisedën e përgjuar me **nr.595, datë 11.09.2016**, i pandehuri Robert Aga, në atë kohë me detyrë Shef i Komisarariatit të Policisë Dibër, nëpërmjet formave të paligjshme (ndërhyrjeve), vihet në mbështetje të kandidatit të ASHE-së.

Gjatë bisedës së përgjuar, rezulton se Shefi i Komisarariatit të Policisë Dibër, Robert Aga, ndërhyr tek një person, përdorues i nr.celular 069 51 61 338, të cilit i thotë: *"A i'u the që ia kam dhënë Bert Agës...?"* dhe personi i përgjigjet *"Unë ta dhashë llafin që do të ta jap, tani kto më çmendin, më thonë ia ke dhënë PD -së.Tani nuk e di..."*. Berti i thotë *"ja të flas unë, po çojë mamën që të votojë ti..."* dhe personi i thotë *"ja po ik mamë tani..."*. Berti i thotë *"çojë mamën që të votojë hapur ajo dhe mirupafshim..."* dhe personi i thotë *"Mera më ka thënë mua personalisht nëse nuk voton për mua je i heqëm dhe unë i thashë vetëm hiqëm"* dhe Berti i thotë *"të çon vëllai jot..."*.

Mbështetja e një force të caktuar politike nga Shefi i Komisarariatit të Policisë Dibër Robert Aga, vjen në kundërshtim me *nenin 4, pika "2"* dhe *nenin 90, pika "b", të ligjit nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit"*, pasi në këtë rast, është shkelur statusi i Policisë së Shtetit, **pra veprimtaria e depolitizuar** e shërbimit policor dhe gjithashtu edhe kufizimi i sanksionuar me ligj që ***punonjësit të policisë i ndalohet kategorikisht të mbështesë fushatën e një force politike.***

Veprimi i kryer me dashje dhe me qëllim mbështetjen e një force të caktuar politike, përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës me pasojë dëmtimin e interesave të institucionit të policisë së shtetit.

-Në episodin e evidentuar në bisedat e përgjuara me **nr.729, 7.32 dhe 735, datë 11.09.2016**, personi nën hetim Robert Aga, në atë kohë me detyrë Shef i Komisarariatit të Policisë Dibër, nëpërmjet formave të paligjshme (ndërhyrjeve), vihet në mbështetje të kandidatit të ASHE-së.

Gjatë bisedës së përgjuar, rezulton se Shefi i Komisarariatit të Policisë Dibër, Robert Aga, ndërhyr tek një person, i quajtur Gysi, përdorues i nr.celular 068 68 71 666, që ky i fundit të shkojë të votojë.Konkretisht Roberti i thotë Gysit: *"Kur do shkosh mo...?"* dhe Gysi i përgjigjet *"ja tani jam tu u nis se kisha shumë punë..."*. Roberti i thotë *"hajde tani, të lutem..."*. Gysi e pyet *"a je aty...?"* dhe Roberti përgjigjet *"çke ti se ku jam unë..."*.

Mbështetja e një force të caktuar politike nga Shefi i Komisarariatit të Policisë Dibër Robert Aga, vjen në kundërshtim me *nenin 4, pika "2"* dhe *nenin 90, pika "b", të ligjit nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit"*, pasi në këtë rast, është shkelur statusi i Policisë së Shtetit, **pra veprimtaria e depolitizuar** e shërbimit policor dhe gjithashtu edhe

kufizimi i sanksionuar me ligj që ***punonjësit të policisë i ndalohet kategorikisht të mbështesë fushatën e një force politike.***

Veprimi i kryer me dashje dhe me qëllim mbështetjen e një force të caktuar politike, përbën mospërmbyshje të rregullt të detyrës me pasojë dëmtimin e interesave të institucionit të policisë së shtetit.

-Në episodin e evidentuar në bisedat e përgjuara me **nr.741 dhe 751, datë 11.09.2016**, i pandehuri Robert Aga, në atë kohë me detyrë Shef i Komisarariatit të Policisë Dibër, vendos funksionin e tij policor, në mbështetje të kandidatit të ASHE-së.

Gjatë bisedave, një person, përdorues i nr.celular 069 36 21 826, i thotë Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, Robert Aga: “Merre një çikë vocin Nuz Hames, bëji një çikë presion këtij legeni...” dhe Roberti i thotë “patjetër...”. Menjëherë pas telefonatës, personi nën hetim Robert Aga, komunikon me një person me emrin Qemal, përdorues i nr.celular 068 25 38 685, të cilit i thotë: “Shife atë djalë e atij Hames, hë më se e ke parasysh, i’a ke telefonin ti se i kërkojnë të shkojnë të votojnë” dhe Qemali i përgjigjet “po po, se e gjej unë për dy minuta”. Roberti i thotë “shko thuaj për hatër tim”.

Mbështetja e një force të caktuar politike nga Shefi i Komisarariatit të Policisë Dibër, Robert Aga, vjen në kundërshtim me ***nenin 4, pika “2” dhe nenin 90, pika “b”, të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”***, pasi në këtë rast, është shkelur statusi i Policisë së Shtetit, ***pra veprimtaria e depolitizuar*** e shërbimit policor dhe gjithashtu edhe kufizimi i sanksionuar me ligj që ***punonjësit të policisë i ndalohet kategorikisht të mbështesë fushatën e një force politike.***

Veprimi i kryer me dashje dhe me qëllim mbështetjen e një force të caktuar politike, përbën mospërmbyshje të rregullt të detyrës me pasojë dëmtimin e interesave të institucionit të policisë së shtetit.

-Në episodin e evidentuar në bisedën e përgjuar me **nr.787, datë 11.09.2016**, i pandehuri Robert Aga, në atë kohë me detyrë Shef i Komisarariatit të Policisë Dibër, vendos funksionin e tij policor, në mbështetje të kandidatit të ASHE-së.

Gjatë bisedës, Shefi i Komisarariatit të Policisë Dibër, Robert Aga, i thotë një vartësit të tij, punonjësit të policisë Azbi Biçi: “Ti i ke çu njerëzit e tuj të votojnë...?” dhe Azbiu përgjigjet “patjetër që po, i kam çu me makinë dhe i kam afër...”.

Edhe në këtë episod, rezulton se personi nën hetim Robert Aga, duke qenë në pozicionin e eprorit për punonjësin e policisë Azbi Biçi, kujdeset që të sigurojë edhe votën e vartësit të tij, pro kandidatit të ASHE-së.

Mbështetja e një force të caktuar politike nga Shefi i Komisarariatit të Policisë Dibër, Robert Aga, vjen në kundërshtim me ***nenin 4, pika “2” dhe nenin 90, pika “b”, të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”***, pasi në këtë rast, është shkelur statusi i Policisë së Shtetit, ***pra veprimtaria e depolitizuar*** e shërbimit policor dhe gjithashtu edhe kufizimi i sanksionuar me ligj që ***punonjësit të policisë i ndalohet kategorikisht të mbështesë fushatën e një force politike.*** Ky veprim, i kryer me dashje dhe me qëllim mbështetjen e një force të caktuar politike, përbën mospërmbyshje të rregullt të detyrës me pasojë dëmtimin e interesave të institucionit të policisë së shtetit.

-Në bisedat e përgjuara me nr.995, 1009, 1245, datë 12.09.2016, nr.2178, 2179, datë 13.09.2016, dhe 2437, datë 14.09.2016, i pandehuri Robert Aga, në atë kohë me detyrë Shef i Komisarariatit të Policisë Dibër, pohon qartë mbështetjen dhe kontributin që ai i ka dhënë me anë të funksionit, për kandidatin e ASHE-së, veprime të cilat vijnë në kundërshtim **nenin 4, pika "2"** dhe **nenin 90, pika "b"**, të ligjit nr.108/2014, "**Për Policinë e Shtetit**", pasi rezultojnë të jetë shkelur statusi i Policisë së Shtetit, **pra veprimtaria e depolitizuar** e shërbimit policor dhe gjithashtu edhe kufizimi i sanksionuar me ligj që **punonjësit të policisë i ndalohej kategorikisht të mbështesë fushatën e një force politike**, fakte të cilat përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës me pasojë dëmtimin e interesave të institucionit të policisë së shtetit.

-Në episodin e evidentuar në komunikimet e përgjuara me nr.2009, 20012, 2018, 2021, 2024, 2025, 2026, 2031, 2035, 2037, 2040, 2024, 20248, 2053 dhe 2058, datë 13.09.2016, i pandehuri Robert Aga, në atë kohë me detyrë Shef i Komisarariatit të Policisë Dibër, vendos tërësisht funksionin e tij policor, jo vetëm në mbështetje të një force të caktuar politike por edhe në funksion të mbulimit të një vepre penale për të cilën vihet në dijeni.

Konkretisht, gjatë bisedave dhe komunikimeve me SMS, personi nën hetim Robert Aga, me detyrë Shef i Komisarariatit të Policisë Dibër, vihet në dijeni nga një person me emrin Juli, përdorues i nr.celular 067 40 50 505, për faktin se nga një person i quajtur Blerim Bajrami, i datëlindjes 28.11.1994, nga fshati Sohodoll, i Kastriotit, në bashkëpunim me një person të quajtur Shpëtim, nga Vojnika e Maqellarës, ishte bërë një video-filmim, sipas së cilës, disa persona, mbështetës të kandidatit të Aleancës për Shqipërinë Evropiane, (ASHE), shfaqeshin duke ofruar para në këmbim të votave.

Sipas të dhënave të marra nga personi me emrin Juli, shtetasi Blerim Bajrami, ishte nisur në drejtim të Tiranës, me një automjet Benz, i zi, C Class 220, me portobagazh, me qëllim për të dërguar materialin filmik në ndonjë televizion.

Gjatë bisedave, personi me emrin Juli, i kërkon Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, Robert Aga, që të bëjë ndalimin e shtetasit Blerim Bajrami, me qëllim pengimin e tij për të bërë publike video-filmimin.

Pas marrjes dijeni lidhur me këtë fakt, Shefi i Komisarariatit të Policisë Dibër, në shpërdorim të funksionit të tij policor, ndërmerr veprime aktive, për të ndaluar shtetasin Blerim Bajrami, ku konkretisht njofton punonjësit e policisë rrugore të Komisarariatit të Policisë Mat, që të bëjnë postbllok për ndalimin e shtetasit Blerim Bajrami.

Nga komunikimet e përgjuara, ka rezultuar se sipas udhëzimeve të Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, Robert Aga, punonjësit e policisë rrugore të Komisarariatit të Policisë Mat, pozicionohen në postbllok, me qëllim ndalimin e shtetasit Blerim Bajrami, por që në fakt nuk bëjnë të mundur ndalimin e tij, pasi gabimisht ndalojnë një tjetër automjet, konkretisht mjetin Mercedes Benz, me drejtues shtetasin Haki Meta, i cili më pas lihet i lirë pasi personi nën hetim Robert Aga, i'u konfirmon se nuk ishte ai personi që kërkonin.

Nga verifikimet e kryera, ka rezultuar se në datën 13.09.2016, kur Shefi i Komisarariatit të Policisë Dibër, bën përpjekje të ndalojë shtetasin Blerim Bajrami dhe personin tjetër nga Vojnika e Maqellarës, që të mos publikojnë video-filmimin, pikërisht në këtë datë, në emisionin investigativ "STOP", të televizionit KLAN, transmetohen pamje filmike, ku në afërsi të qendrës së votimit të ngritur pranë shkollës 9-vjeçare të fshatit Kllobcisht, evidentohen persona të cilët ofrojnë para në këmbim të votës.

Në këtë rast, veprimet dhe mosveprimet e të pandehurit Robert Aga, vijnë në kundërshtim me **nenin 17, pika 1, gërma “c”, të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, dhe nenin 30/2 të Kodit të Procedurës Penale**, pasi punonjësi i policisë edhe pse vihet në dijeni të një rasti ku është filmuar korrupsioni zgjedhor, jo vetëm që nuk ka ndërmarrë veprime në drejtim të hetimit dhe grumbullimit të provave për këtë vepër penale dhe zbulimit të autorëve të saj, por përkundrazi, në kundërshtim me detyrat e tij, me veprime aktive, ka shpërdoruar funksionin e tij, jo vetëm duke patur për qëllim ndalimin e publikimit të këtij rasti por edhe të mbulimit të kësaj vepre penale të kryer.

Veprimet dhe mosveprimet të pandehurit Robert Aga, të kryera me dashje të drejtpërdrejtë dhe në kundërshtim me ligjin, përbëjnë mospërmbyllje të rregullt të detyrës me pasojë dëmtimin e interesave të institucionit të policisë së shtetit dhe gjithashtu edhe të shtetasve.

-Lidhur me **të pandehurin Drini Gjeci**, i cili në momentin e realizimit të veprës penale ka mbajtur detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Dibër, janë provuar këto episode të kanosjes së zgjedhësit:

-Në episodin e evidentuar në bisedën përgjuar me **nr.393, datë 11.09.2016**, i pandehuri Drini Gjeci, i cili në momentin e realizimit të veprës ka mbajtur detyrën si Drejtor i Drejtorisë Arsimore Dibër, rezulton të ketë kanosur vartësin e tij, shtetasin Reshat Elezaj, në atë kohë me detyrë Drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Halil Selmani”, Zall-Reç, me qëllimin e posaçëm që ky i fundit, në zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Dibër, të datës 11 shtator 2016, të votojë pro kandidatit të ASHE-së.

Gjatë bisedës së zhvilluar, ndërmjet të pandehurit hetim Drini Gjeci dhe shtetasit Reshat Elezaj, Drini i thotë Reshatit: *“Ku je?”*, Reshati përgjigjet *“t’u ra ke qendra e votimit...”*. Drini e pyet *“I ke marrë të gjithë ato të familjes...?”* dhe Reshati i përgjigjet *“Nuk jam tu ra me votu tani, më vonë”*. Drini e pyet *“në ç’farë qendre voton ti ...?”* dhe Reshati i përgjigjet *“këtu në Zall Reç...”*. **Drini me ton kërcënues i thotë “Dëgjo se kam informacione jo të mira andej unë Sot vota jote një, dhe e familjes tënde dy, do të deklarohen haptas. Nuk ke deklaruar votën haptas sot bashkë me familje... qej ku të shkosh...”**. Reshati i thotë *“Drejtor mos e vrit mendjen me atë punë fare...”*. **Drini përsëri me ton kërcënues vazhdon “ore do të deklarohet haptas, haptas. Kur them haptas, haptas...”** dhe Reshati përgjigjet *“po mos e vrit mendjen fare, pa merak, pa merak”*. Drini i thotë përsëri **“haptas me gjithë familjen...”** dhe Reshati përgjigjet **“pa merak, pa merak, pa merak”**.

-Në një tjetër episod, të evidentuar në bisedën përgjuar me **nr.517, datë 11.09.2016**, i pandehuri Drini Gjeci, i cili në momentin e realizimit të veprës ka mbajtur detyrën si Drejtor i Drejtorisë Arsimore Dibër, ka kanosur një tjetër vartës të tij, konkretisht shtetasin Lavdrim Murati, në atë kohë me detyrë mësues në shkollën 9-vjeçare “Halil Selmani”, Zall-Reç, me qëllimin e posaçëm, që ky person të votojë pro kandidatit të të ASHE-së.

Gjatë bisedës, së zhvilluar ndërmjet shtetasit Drini Gjeci dhe shtetasit Lavdrim Murati, rezulton se: Drini i thotë Lavdrimit: *“Lavdrim Murati...?”*, Lavdrimi përgjigjet *“po”*. Drini i thotë *“Drejtori i Arsimit në Telefon...”*, Lavdrimi i thotë *“Urdhëro”*. Drini e pyet *“Lavdrim, a ke votu...?”* dhe Lavdrimi përgjigjet *“Jo akoma”*. Drini e pyet **“po pse mor Lavdrim nuk**

ke votu akoma...?”, Lavdrimi përgjigjet “s’kam votu se thashë të lirohet njëherë rradha”. Drini i thotë “Lavdrim, mos kemi llafe, votat i dua haptas atje, mos kemi llafe mo...” dhe Lavdrimi i përgjigjet “Ça flet mor drejtor, zbëhet llaf ajo punë...”. Drini i thotë “mos të të pres në besë, 5 vota sa ke t’i dua...” dhe Lavdrimi i thotë “jo jo, pa merak, të paskan sinjalizu gabim”. Drini i thotë “nejse unë ktë llaf po të them pastaj ti e di vetë...” dhe Lavdrimi i thotë “në rregull, në rregull”.

Ushtrimi në mënyrë të përsëritur, i dhunës psikologjike ndaj zgjedhësve, me qëllimin për ti detyruar ato për të votuar në një mënyrë të caktuar, plotëson elementët e veprës penale “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer më shumë se një herë, parashikuar nga neni 329/3 i Kodit Penal.

-Lidhur me të pandehurin **Drini Gjeci**, i cili në momentin e realizimit të veprës penale ka mbajtur detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Arsimore Dibër, janë provuar edhe episode të shpërdorimit të detyrës dhe konkretisht:

-Në episodin e evidentuar në bisedën e përgjuar me nr.9, datë 09.09.2016, i pandehuri Drini Gjeci, në atë kohë me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Dibër, në kundërshtim me detyrën e tij, vendos në dispozicion të fushatës politike të kandidatit të Aleancës për Shqipërinë Europiane, (ASHE), punonjës të institucioneve arsimore, në vartësi të tij.

Në këtë episod, Drejtori i Arsimit Drini Gjeci, urdhëron një punonjëse, vartëse të tij, të quajtur Sabrie, përdoruese e nr.celular 06 33 87 655, që bashkë me punonjësit e tjerë të bëhen gati për të shkuar në mitingun përmbyllës të Aleancës për Shqipërinë Europiane, (ASHE), i cili nga verifikimet e kryera rezultojnë të jetë zhvilluar në qytetin e Peshkopisë, ditën e premte, me datë 09.09.2016, në orët e paradites.

Konkretisht, gjatë bisedës së përgjuar, Drini me ton urdhërues, i thotë vartës së tij, Sabries: “*edhe bëhuni gati për takim atje poshtë, dilni të gjithë atje poshtë...*”.

Në këtë rast, veprimet e të pandehurit Drini Gjeci, vijnë në kundërshtim me **nenin 8 dhe nenin 32, pika “4”, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”,** pasi në këto dispozita sanksionohet se arsimi parauniversitar është i depolitizuar dhe gjithashtu ndalohet organizimi i veprimtarive partiake në institucionet e sistemit arsimor parauniversitar.

Detyrimi i vartësve të tij për të marrë pjesë në tubimin e organizuar nga një force e caktuar politike, dhe për më tepër në një ditë pune, ditë e premte, datë 09.09.2016, përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës nga i pandehuri Drini Gjeci, pasi në këtë rast, rezultojnë se me veprimet e tij të kundërligjshme, ai ka cënuar interesat e ligjshëm të institucionit arsimor, si dhe të drejtat dhe liritë politike të shtetasve, (në këtë rast të punonjësve të arsimit), të cilët sipas **nenit 46, pika “1”, të Kushtetutës së RSH,** kanë të drejtë të organizohen kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm por jo të detyrohen për të marrë pjesë në organizime të tilla.

-Në episodin e evidentuar në bisedat e përgjuara me nr.14, 15, 16, 57 dhe 58, datë 09.09.2016, i pandehuri Drini Gjeci, në atë kohë me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Dibër, pas udhëzimeve të marra nga Kryetari i Partisë Socialiste Dibër, Afrim

Mikli, në kundërshtim me detyrën e tij, vendos në dispozicion të fushatës politike të kandidatit të Aleancës për Shqipërinë Europiane, (ASHE), sërish punonjës të institucioneve arsimore në vartësi të tij, duke i urdhëruar ato që të marrin pjesë në mitingun përmbyllës të tyre, i cili nga verifikimet e kryera rezulton të jetë zhvilluar në qytetin e Peshkopisë, ditën e premte, me datë 09.09.2016, në orët e paradites.

Gjatë bisedave të përgjuara ka rezultuar se, fillimisht Kryetari i PS-së Dibër, shtetasi Afrim Mikli pyet Drejtorin e Arsimit Drini Gjeci: *“këto drejtorët i ke marrë besoj për sot ëë...?”* dhe Drini i përgjigjet *“po mor i kam marrë në telefon ato...”*, duke nënkuptuar se i ka njoftuar për të marrë pjesë në mitingun përmbylles të ASHE-së.

Pas komunikimit me Kryetarin e PS-së, Drejtori i Arsimit Drini Gjeci, telefonon Drejtorin e Gjimnazit Maqellarë shtetasin Gëzim Qoku, përdorues i nr.celular 068 64 34 658 të cilit i thotë: *“O Gzim ku je...?”*, Gëzimi përgjigjet *“duke ardhur për Peshkopi...”*. Drini e pyet *“A keni njoftim për sot or ti...?”* dhe Gëzimi i përgjigjet *“posi or ti”*. Drini e pyet *“mësuesit a i keni njoftuar...”* dhe Gëzimi i përgjigjet *“po po”*, duke nënkuptuar se janë njoftuar për të marrë pjesë në miting.

Pas kësaj telefonate, Drejtori i Arsimit, Drini Gjeci, telefonon edhe një shtetas tjetër, të quajtur Arjan, përdorues i nr.celular 068 61 53 600, i cili nga biseda nënkuptohet se mban detyrën e drejtorit të një shkolle, ku gjatë bisedës Drini i thotë: *“nga je...?”* dhe Arjani i përgjigjet *“duke ardhur për Peshkopi...”*. Drini e pyet *“a keni bërë njoftim mësuesish...?”* dhe Arjani i thotë *“Ç’farë njoftimi psh...?”*, Drini përgjigjet *“për sot mo takimin...”* dhe Arjani i përgjigjet *“po mor po, t’u ardh jam me mësuesit...”*, duke nënkuptuar që po vijnë në miting.

Pas pak kohësh, Drejtori i Arsimit Drini Gjeci, komunikon me një person përdorues i nr.celular 069 20 33 847, i cili e pyet Drinin: *“si shkoi mitingu...?”* dhe Drini po me SMS i përgjigjet *“Shumë mirë...”*, fakt i cili tregon edhe njëherë se po atë ditë është zhvilluar miting dhe punonjësit e institucioneve arsimore sipas urdhrit të Drini Gjecit kanë marrë pjesë në këtë tubim.

Edhe në këtë rast, veprimet e të pandehurit Drini Gjeci, vijnë në kundërshtim me **nenin 8 dhe nenin 32, pika “4”, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”**, pasi sipas këtyre dispozitave ligjore sanksionohet se arsimi parauniversitar është i depolitizuar dhe gjithashtu ndalohet organizimi i veprimtarive partiake në institucionet e sistemit arsimor parauniversitar.

Detyrimi i vartësve të tij, (drejtorëve të shkollave dhe mësuesve), për të marrë pjesë në tubimin e organizuar nga një forcë e caktuar politike, dhe për më tepër në një ditë pune, ditë e premte, datë 09.09.2016, përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës nga i pandehuri Drini Gjeci, pasi në këtë rast, rezulton se me veprimet e tij të kundërligjshme, ai ka cënuar interesat e ligjshëm të institucionit arsimor dhe nxënësve, pasi sipas **nenit 6, pika “1”, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”**, në veprimtarinë e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar interesi i nxënësit është parësor, dhe gjithashtu ka cënuar edhe liritë dhe të drejtat politike të shtetasve, (në këtë rast të punonjësve të arsimit), të cilët sipas **nenit 46, pika “1”, të Kushtetutës së RSH**, kanë të drejtë të organizohen kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm por jo të detyrohen për të marrë pjesë në organizime të tilla.

-Në episodin e evidentuar në bisedën e përgjuar me **nr.393, datë 11.09.2016**, i pandehuri Drini Gjeci, në atë kohë me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Dibër, duke shpërdoruar funksionin dhe autoritetin e tij si Drejtor Arsimit, kërcënon me largim nga puna vartësin e tij, shtetasin Reshat Elezaj, me detyrë Drejtor i Shkollës 9-vjeçare “Halil Selmani”, Zall-Reç, me qëllimin e posaçëm që ky i fundit, në zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Dibër, të datës 11 shtator 2016, të votojë pro kandidatit të ASHE-së.

Gjatë bisedës së zhvilluar, ndërmjet të pandehurit Drini Gjeci dhe shtetasit Reshat Elezaj, rezulton se: Drini i thotë Reshatit: “*Ku je?*”, Reshati përgjigjet “*t’u ra ke qendra e votimit...*”. Drini e pyet “*I ke marrë të gjithë ato të familjes...?*” dhe Reshati i përgjigjet “*Nuk jam tu ra me votu tani, më vonë*”. Drini e pyet “*në ç’farë qendre voton ti ...?*” dhe Reshati i përgjigjet “*këtu në Zall Reç...*”. **Drini me ton kërcënues i thotë “Dëgjo se kam informacione jo të mira andej unë Sot vota jotë një, dhe e familjes tënde dy, do të deklarohen haptas. Nuk ke deklaruar votën haptas sot bashkë me familje... qej ku të shkosh...”**. Reshati i thotë “*Drejtor mos e vrit mendjen me atë punë fare...*”. **Drini përsëri me ton kërcënues vazhdon “ore do të deklarohet haptas, haptas. Kur them haptas, haptas...”** dhe Reshati përgjigjet “*po mos e vrit mendjen fare, pa merak, pa merak*”. Drini i thotë përsëri “***haptas me gjithë familjen...***” dhe Reshati përgjigjet “*pa merak, pa merak, pa merak*”.

Veprimet e personit të pandehurit Drini Gjeci në këtë rast, vijnë në kundërshtim me **nenin 6, pikat “1” dhe “2”, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”,** pasi sipas këtyre dispozitave ligjore sanksionohet se ***në sistemin arsimor parauniversitar respektohen, mbrohen dhe promovohen të drejtat dhe liritë e njeriut dhe gjithashtu punonjësve u ofrohet një mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t’u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral.***

Në këtë rast, i pandehuri Drini Gjeci, si drejtues i njësisë arsimore vendore, jo vetëm që nuk ka respektuar dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë e vartësit të tij por përkundrazi, i ka shkelur haptazi ato, duke ushtruar presion psikologjik me largim nga puna ndaj drejtorit të shkollës Reshat Elezaj, me qëllimin për t’a detyruar që ai të votojë në një mënyrë të caktuar.

Veprimet e të pandehurit Drini Gjeci, përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës dhe gjithashtu kanë cënuar interesat e ligjshëm të shtetasit Reshat Elezaj dhe konkretisht ***të drejtën e zgjedhjes, të parashikuar në nenin 45, pika “1”, të Kushtetutës së RSH.***

-Në episodin e evidentuar në bisedën e përgjuar me **nr.517, datë 11.09.2016**, i pandehuri Drini Gjeci, në atë kohë me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Dibër, duke shpërdoruar funksionin dhe autoritetin e tij si Drejtor Arsimit, kërcënon me largim nga puna vartësin e tij, shtetasin Lavdrim Murati, me detyrë mësues në Shkollën 9-vjeçare “Halil Selmani”, Zall-Reç, me qëllimin e posaçëm që ky i fundit, në zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Dibër, të datës 11 shtator 2016, të votojë pro kandidatit të ASHE-së.

Gjatë bisedës së përgjuar, Drini i thotë Lavdrimit: “***Lavdrim Murati...?***”, Lavdrimi përgjigjet “*po*”. Drini i thotë “***Drejtori i Arsimit në Telefon...***”, Lavdrimi i thotë “*Urdhëro*”. Drini e pyet “***Lavdrim, a ke votu...?***” dhe Lavdrimi përgjigjet “*Jo akoma*”. Drini e pyet “***po pse mor Lavdrim nuk ke votu akoma...?***”, Lavdrimi përgjigjet “*s’kam votu se thashë të lirohet njëherë rradha*”. Drini i thotë “***Lavdrim, mos kemi llafe, votat i dua haptas atje, mos kemi llafe mo...***” dhe Lavdrimi i përgjigjet “***Ça flet mor drejtor, z’bëhet llaf ajo punë***”. Drini i

thotë “*mos të të pres në besë, 5 vota sa ke, t’i dua...*” dhe Lavdrimi i thotë “*jo jo, pa merak, të paskan sinjalizu gabim*”. Drini i thotë “*nejse, unë ktë llaf po të them, pastaj ti e di vetë...*” dhe Lavdrimi i thotë “*në rregull, në rregull*”.

Veprimet e të pandehurit Drini Gjeci në këtë rast, vijnë në kundërshtim me **nenin 6, pikat “1” dhe “2”, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”**, pasi sipas këtyre dispozitave ligjore sanksionohet se në sistemin arsimor parauniversitar **respektohen, mbrohen dhe promovohen të drejtat dhe liritë e njeriut** dhe gjithashtu **punonjësve u ofrohet një mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi** që mund t’u shkaktojë **diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral**.

Në këtë episod, i pandehuri Drini Gjeci, si drejtues i njësisë arsimore vendore, jo vetëm që nuk ka respektuar dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë e vartësit të tij por përkundrazi, i ka shkelur haptazi ato, duke ushtruar presion psikologjik me largim nga puna ndaj mësuesit Lavdrim Murati, me qëllimin për t’a detyruar që ai të votojë në një mënyrë të caktuar.

Veprimet e të pandehurit Drini Gjeci, përbëjnë mospërmbyllje të rregullt të detyrës dhe gjithashtu kanë cënuar interesat e ligjshëm të shtetasit Lavdrim Murati dhe konkretisht **të drejtën e zgjedhjes**, të parashikuar në **nenin 45, pika “1”, të Kushtetutës së RSH**.

-Në episodin e evidentuar në bisedat e përgjuara me **nr.1456, datë 20.09.2016**, dhe **nr.1794, datë 23.09.2016**, rezulton se shtetasi Afrim Mikli, në atë kohë Kryetar i PS-së Dibër, i kërkon të pandehurit Drini Gjeci, në atë kohë me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Dibër, që të largojë nga puna Drejtorin e Shkollës, shtetasin Reshat Elezaj, pasi ky i fundit nuk kishte punuar në favor të tyre në zgjedhjet e datës 11 shtator 2016.

Në komunikimin e datës 20.09.2016, ndërmjet Drinit dhe Afrimit zhvillohet kjo bisedë: Drini i thotë Afrimit: “*nuk kam bërë asnjë lëvizje mor Afrim*” dhe Afrimi i thotë “*mos bëj edhe ktë javë deri kur të vijmë ne*”. Gjithashtu Afrimi i thotë Drinit “*hiq nga puna atë Reshat Elezin që është në shkollën e Reçit...*”, ndërsa Drini i thotë “*e heq mor unë, po unë ju pres juve...*”. Afrimi i thotë “*hiqe, mos më prit fare po qërroje direkt...*”, Drini i përgjigjet “*po e heq mor unë se është e thjeshtë ajo, po puna është se ka një vëlla sekretar asambleje...*”. Afrimi i thotë “*ai nuk ka punu fare...*”. Afrimi i thotë gjithashtu “*hiq një person me emrin Sadik dhe vendos një person me emrin Përparim*” dhe Drini i thotë “*po unë juve ju pres*”.

Gjatë bisedës së datës 23.09.2016, ndër të tjera, Afrimi i thotë edhe një herë Drinit **të largojë nga puna Reshat Elezin dhe Drini i thotë “dakort”**.

Nga verifikimet e mëpasshme të kryera nga policia gjyqësore në Zyrën Vendore Arsimore Dibër, ka rezultuar se në harkun kohor të rreth 20 ditëve nga komunikimi i Drini Gjecit me Kryetarin e PS-së Afrim Mikli, është bërë edhe lirimi i shtetasit Reshat Elezaj, nga detyra e Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Halil Selmani”, Zall-Reç, me motivacionin “**ka vend për përmirësimin e punës**”, ku vendimi i lirimit me nr.43, datë 10.10.2016, mban firmën e Drejtorit të Arsimit Drini Gjeci.

Në këtë rast, lirimi i shtetasit Reshat Elezaj, nga detyra e Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Halil Selmani”, Zall-Reç, është bërë tërësisht për motive polititike, të provuara plotësisht me bisedat e përgjuara, dhe gjithashtu edhe në kundërshtim flagrant me **nenin 55, pika 3, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”** dhe **Kreun II, pika “C”, të Udhëzimit nr.57, datë 12.11.2013, “Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të drejtorit të**

institucionit të arsimit parauniversitar”, për faktin se Reshat Elezaj, është liruar nga detyra pa u kryer asnjë procedurë paraprake e vlerësimit të punës së tij dhe gjithashtu duke u anashkaluar bordi i institucionit arsimor, i cili me shumicën e votave të fshehta të tij, duhet të jepte pëlqimin për shkarkimin e drejtorit sipas propozimit të titullarit të njësisë arsimore vendore.

Pra në këtë rast, kur titullari i njësisë arsimore vendore nëse konstatonte se drejtori kishte kryer shkelje të legjislacionit në fuqi, ose kur shkolla kishte rezultate të ulëta në testime ose inspektime, duhet ti paraqiste bordit të institucionit arsimor nismën e shkarkimit dhe jo të ndërmernte një vendim duke i anashkaluar ato.

Veprimet e të pandehurit Drini Gjeci, në cilësinë e Drejtorit të Arsimit Dibër, përbëjnë mospërmbyllje të rregullt të detyrës nga ana e tij dhe gjithashtu kanë sjellë cënimin e interesave të ligjshëm të shtetasit Reshat Elezaj, i cili nuk rezulton të jetë larguar nga detyra për shkaqe ligjore por tërësisht për motive politike.

-Lidhur me **të pandehurin Hasan Hoti**, i cili në momentin e realizimit të veprës penale ka mbajtur detyrën e Administratorit të Njësisë Administrative Lurë, bashkia Dibër, janë provuar këto episode të kanosjes së zgjedhësit:

-Në një episod, të evidentuar në bisedën përgjuar me **nr.483, datë 10.09.2016**, i pandehuri Hasan Hoti, në atë kohë me detyrë Administrator i Njësisë Administrative Lurë, rezulton të ketë kanosur një person, i cili identifikohet se është përdorues i nr.celular 068 23 41 446, me qëllimin e posaçëm që ky i fundit, në zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Dibër, të datës 11 shtator 2016, të votojë pro kandidatit të ASHE-së.

Gjatë bisedës së zhvilluar, ndërmjet të pandehurit Hasan Hoti dhe personit të kanosur, përdorues i nr.celular 068 21 87 497, rezulton se: *Hasani i thotë bashkëbiseduesit: “shife se janë piketuar edhe nja dy persona këtu... (duke nënkuptuar për largim nga puna), mbaje atë porosinë që ta kam dhënë...(duke nënkuptuar mbajtjen e fjalës për të votuar pro kandidatit të ASHE-së)” dhe personi i përgjigjet “më vjen keq po unë jua kam shkatërru llafet edhe me ty edhe me Melaimin”.Hasani i thotë “do të votoni aty dhe ti mbaje me kamer, ndize kamerën dhe ajo kamera nuk bën shkrepte sepse kshu ma kërkojnë se ka ik edhe tjetri...” (duke nënkuptuar se një person tjetër është larguar nga puna dhe mund të largohesh edhe ti) dhe personi i përgjigjet “po mirë, mos e vrit mendjen”.*

-Në një tjetër episod, të evidentuar në bisedën përgjuar me **nr.957, datë 11.09.2016**, i pandehuri Hasan Hoti, i cili në momentin e realizimit të veprës ka mbajtur detyrën si Administrator i Njësisë Administrative Lurë, ka kanosur një tjetër person, i cili identifikohet me emrin Qamil dhe është përdorues i nr.celular 068 60 53 309, me qëllimin e posaçëm, që ky person të votojë pro kandidatit të të ASHE-së.

Gjatë bisedës, së zhvilluar ndërmjet të pandehurit Hasan Hoti dhe personit të kanosur, me emrin Qamil, përdorues i nr.celular 068 60 53 309, rezulton se: Drini i thotë Qamilit: *“dëgjom me vëmendje.Do të ta ndaloj centralin me vendim të këshillit bashkiak.Merre Bashkimin në telefon, i thuaji merr çunin e Mitatit, të votojë çuni i Mitatit me nënën e vet”. Qamili i përgjigjet “mirë”. Hasani i thotë “nuk e çoi e nuk votoi me çunin e Mitatit, ta*

harrosh. Hebabin e Bashkimin do t'i mbaj me hu dhe nuk kan me hy aty tek dajat e mi
dhe Qamili i përgjigjet “*mirë*”.

Ushtrimi në mënyrë të përsëritur, i dhunës psikologjike ndaj zgjedhësve, me qëllimin për ti detyruar ato për të votuar në një mënyrë të caktuar, plotëson elementët e veprës penale “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer më shumë se një herë, parashikuar nga neni 329/3 i Kodit Penal.

-Lidhur me **të pandehurin Nuri Meda**, i cili në momentin e realizimit të veprës penale ka mbajtur detyrën e Administratorit të Njesisë Administrative Tomin, bashkia Dibër, është provuar vetëm një episod i mospërmbushjes së rregullt të detyrës dhe konkretisht:

-Në bisedat e përgjuara me **nr.1758, 1760, 1779, 1781, 1784 dhe 1830, datë 21.09.2016**, rezulton se i pandehuri Nuri Meda, në atë kohë me detyrë Administrator i Njesisë Administrative Tomin, bashkia Dibër, urdhëron vartësen e tij, Adelina Çenga, punonjëse e Njesisë Administrative Tomin, përdoruese e nr.celular 069 36 92 333, që të largojë nga skema e ndihmës ekonomike persona të cilët sipas tij nuk e kanë mbështetur politikisht, në zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Dibër, të zhvilluara me datë 11 shtator 2016, ku shtetasi Nuri Meda ka mbështetur kandidatin e Aleancës Për Shqipërinë Evropiane, (ASHE).

Nga bisedat e përgjuara, Administratori Nuri Meda, urdhëron vartësen e tij Adelina Çenga, që në **fshatin Zdojan**, të largojë nga skema e ndihmës ekonomike shtetasit **1-Neritan Vojka, 2-Mensur Selxhaferri, 3-Islam Kola, 4-Dashamir Tuka, 5-Sinan Sefullaj, 6-Ardian Vojka, 7-Adrian Mirku, 8-Dilaver Driza, 9-Nderim Reçi, 10-Edmond Degjoni, 11-Nexhat Sefullaj dhe 12-Vladimir Ashiku**, të cilët sipas tij nuk e kishin mbështetur politikisht në zgjedhjet e datës 11 shtator 2016.

Nga bisedat e përgjuara, Administratori Nuri Meda, urdhëron vartësen e tij Adelina Çenga, që në **fshatin Ushtelenxë**, të largojë nga skema e ndihmës ekonomike shtetasit **1-Shefik Kica, 2-Asllan Hysa, 3-Artur Kazia, 4-Genci Papuli, 5-Përparim Sallahi, 6-Muharem Zebi, 7-Arben Doçi, 8-Lazim Zebi, 9-Luan Cena, 10-Shuaip Kica, 11-Kujtim Kaziu, 12-Muiz Doçi, 13-Ali Sallahi, 14-Qazim Doçi dhe 15-Lorenc Zebi**, të cilët sipas tij nuk e kishin mbështetur politikisht në zgjedhjet e datës 11 shtator 2016.

Nga bisedat e përgjuara, Administratori Nuri Meda, urdhëron vartësen e tij Adelina Çenga, që në **fshatin Pilafe**, të largojë nga skema e ndihmës ekonomike shtetasit **1-Dashamir Çenga, 2-Nazmi Çenga, 3-Shyqiri Çenga, 4-Kadri Muda, 5-Shkëlqim Muda, 6-Rustan Çenga, 7-Fabio Muda, 8-Qazim Muda, 9-Vehap Muda, 10-Behar Kaba dhe 11-Hekuran Kaba**, të cilët sipas tij nuk e kishin mbështetur politikisht në zgjedhjet e datës 11 shtator 2016.

Nga bisedat e përgjuara, Administratori Nuri Meda, urdhëron vartësen e tij Adelina Çenga, që në **fshatin Zimur**, të largojë nga skema e ndihmës ekonomike shtetasin **1-Mahmut Kamberi**, pasi sipas tij ky person ishte vëllai i shtetasit Bedri Kamberi, i cili nuk e kishte mbështetur politikisht në zgjedhjet e datës 11 shtator 2016.

Me qëllim verifikimin e faktit nëse pas bisedave të datës 21.09.2016, personat e përmendur në këto biseda janë larguar nga skema e ndihmës ekonomike, janë administruar projekt-vendimet dhe vendimet për dhënien e ndihmës ekonomike të Njesisë Administrative Tomin, për periudhën kohore korrik, gusht, shtator dhe tetor 2016, ku nga verifikimet e kryera në këto dokumente, ka rezultuar se personat e mësipërm kanë qenë pjesë e ndihmës ekonomike

për periudhën kohore korrik-gusht 2016, ndërkohë që për periudhën shtator 2016, të gjithë këto persona, nuk janë përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike.

Nga verifikimet e kryera, ka rezultuar se projekt-vendimi i ndihmës ekonomike për periudhën shtator 2016, mban datën 01.10.2016, pra 10 ditë pas bisedës së zhvilluar ndërmjet shtetasit Nuri Meda dhe vartëses së tij Adelina Çenga, fakt i cili vërteton se mospërfshirja e këtyre personave në skemën e ndihmës ekonomike është bërë mbi bazën e udhëzimeve të dhëna nga administratori Nuri Meda, në bisedën e zhvilluar me datë 21.09.2016.

V. KONKLUZIONI I HETIMIT

1-Në lidhje me të pandehurin Robert Aga.

Nga kryerja në tërësi e të gjitha veprimeve hetimore e procedurale dhe në analizë të të gjithë provave e fakteve të grumbulluara, provohet se përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Robert Aga, ka konsumuar plotësisht elementët e figurës së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi në cilësinë e personit që ka ushtruar një detyrë shtetërore, atë të Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, nëpërmjet veprimeve apo mosveprime të kryera me dashje dhe në kundërshtim ligjin, të cilat përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës, ka dëmtuar interesa të ligjshëm të shtetit/institucionit të policisë së shtetit por edhe të shtetasve.

Vendosja e funksionit të tij policor dhe shërbimeve policore në vartësi të tij, në mbështetje të një force politike të caktuar, nga i pandehuri Robert Aga, janë veprime të cilat vijnë në kundërshtim me *nenin 4, pika “2”, nenin 5, pika “dh” dhe nenin 90, pika “b”, të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”*, pasi këto veprime shkelin statusin e Policisë së Shtetit si *“institucion dhe shërbim i depolitizuar”*, shkelin një ndër parimet bazë ku udhëhiqet policia e shtetit në veprimtarinë e saj, atë të *“paanshmërisë politike”* dhe gjithashtu edhe kufizimin e sanksionuar me ligj, që *punonjësit të policisë i ndalohet kategorikisht të mbështesë fushatën e një force politike*. Në këtë rast, rezulton të jenë dëmtuar interesa të ligjshëm të shtetit, pra institucionit të Policisë së Shtetit, për faktin se i pandehuri Robert Aga, në disa raste, funksionin e tij policor dhe atyre të vartësve të tij, nuk e ka vendosur në shërbim të rendit dhe sigurisë publike por në mbështetje të një force politike të caktuar. Gjithashtu rezulton të jenë dëmtuar edhe interesa të ligjshëm të shtetasve, për faktin se prej të pandehurit, Robert Aga, në pozicionin e Shefit të Komisarariatit të Policisë Dibër, nuk i’u është ofruar një shërbim policor i paanshëm gjatë procesit zgjedhor por në disa raste, shtetas të ndryshëm rezultojnë të jenë intimiduar nga ky person me qëllim për të votuar në një mënyrë të caktuar.

Gjithashtu veprimet dhe mosveprimet e të pandehurit Robert Aga, në një episod të caktuar, kanë ardhur në kundërshtim edhe me *nenin 17, pika 1, gërma “c”, të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”*, dhe *nenin 30/2 të Kodit të Procedurës Penale*, pasi punonjësi i policisë edhe përse është vënë në dijeni të një rasti ku është filmuar korrupsion zgjedhor, jo vetëm që nuk ka ushtruar përgjegjësitë e tij, për hetimin dhe grumbullimin e provave të veprës penale të dyshuar dhe zbulimit të autorëve të saj, por përkundrazi, në kundërshtim me detyrat e tij, me veprime aktive, ka shpërdoruar funksionin, me qëllim jo vetëm ndalimin e publikimit të këtij rasti por edhe të mbulimit të veprës penale të dyshuar. Bazuar në *nenin 18, të ligjit*

nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i pandehuri Robert Aga, ashtu si çdo punonjës tjetër policie, ka gëzuar atributet e policisë gjyqësore dhe në përputhje ligjin procedural penal dhe atë për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, me marrjen dijeni për veprën penale të dyshuar, duhet të kryente hetime dhe të grumbullonte gjithçka që i shërbente zbatimit të ligjit penal. Edhe në këtë rast veprimet dhe mosveprimet e të pandehurit Robert Aga, kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit po ashtu edhe të shtetasve.

2-Në lidhje me të pandehurin Drini Gjeci.

Nga kryerja në tërësi e të gjitha veprimeve hetimore e procedurale dhe në analizë të të gjithë provave e fakteve të grumbulluara, provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Drini Gjeci, ka konsumuar plotësisht elementët e figurës së veprës penale “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer më shumë se një herë, parashikuar nga neni 329/3 i Kodit Penal, (në fuqi në vitin 2016), dhe veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Sa i përket veprës penale “**Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje**”, kryer më shumë se një herë, parashikuar nga **neni 329/3 i Kodit Penal**, nga hetimi ka rezultuar se të gjitha rezultatet e përgjimit të analizuara më sipër, krijojnë bindjen e plotë se i pandehuri Drini Gjeci, ka konsumuar veprën penale “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer më shumë se një herë, parashikuar nga neni 329/3 i Kodit Penal, pasi provohet se ky shtetas me veprime aktive të kundërligjshme, të kryera me dashje të drejtpërdrejtë, ka cënuar në mënyrë të përsëritur të drejtën e zgjedhëve, për të votuar lirisht sipas vullnetit të tyre, e drejtë kjo e mbrojtur posaçërisht nga legjislacioni penal.

Nga ana objektive, kanosja e zgjedhësve, është realizuar nga i pandehuri Drini Gjeci, nëpërmjet dhunës psikologjike të ushtruar ndaj tyre, me qëllimin e posaçëm që ato të votojnë pro kandidatit të Aleancës për Shqipërinë Europiane, (ASHE). Egzistenca e raportit epror-vartës, ndërmjet të pandehurit Drini Gjeci dhe shtetasve Reshat Elezaj dhe Lavdrim Murati, bën që kanosja të ketë qenë serioze dhe e vërtetë.

Faktet e dokumentuara në bisedat e përgjuara, përputhen plotësisht me fakte reale të ndodhura në momentin e zhvillimit të ngjarjeve dhe për këtë shkak konsiderohen si prova të plota që vërtetojnë kryerjen e veprës penale nga ky subjekt.

Sa i përket veprës penale “**Shpërdorimi i detyrës**”, parashikuar nga **neni 248 i Kodit Penal**, nga hetimi ka rezultuar se në tërësinë e episodeve të trajtuara më sipër, arrihet në konkluzionin se i pandehuri Drini Gjeci, ka konsumuar plotësisht edhe elementët e figurës së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi në cilësinë e personit që ka ushtruar një detyrë shtetërore, atë të Drejtorit të Drejtorisë Arsimore Rajonale Dibër, nëpërmjet veprimeve apo mosveprimeve të kryera me dashje dhe në kundërshtim me ligjin, të cilat përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës, ka dëmtuar interesa të ligjshëm të shtetit/institucionit arsimor por edhe të shtetasve.

Veprime të tilla, të kryera nga i pandehuri Drini Gjeci, si, detyrimi i vartësve për të marrë pjesë në tumbimin e një force politike dhe për më tepër në një ditë pune, kërcënimi i tyre me largim nga puna me qëllimin për të votuar në një mënyrë të caktuar, si dhe lirimi nga detyra i

një drejtori shkolle për motive politike sikurse është rasti i shtetasit Reshat Elezaj, janë veprime që vijnë në kundërshtim flagrant me normat ligjore e nënligjore të drejtimit të një institucioni arsimor dhe në kushtet kur kanë sjellë për pasojë dëmtimin e interesave të ligjshëm të shtetit dhe të shtetasve, ngarkojnë me përgjegjësi penale sipas nenit 248 të Kodit Penal shtetasin Drini Gjeci.

3-Në lidhje me të pandehurin Hasan Hoti.

Nga kryerja në tërësi e të gjitha veprimeve hetimore e procedurale dhe në analizë të të gjithë provave e fakteve të grumbulluara, provohet se përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Hasan Hoti, ka konsumuar plotësisht elementët e figurës së veprës penale “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer më shumë se një herë, parashikuar nga nenet 329/3 i Kodit Penal, (në fuqi në vitin 2016), pasi ky shtetas me veprime aktive të kundërligjshme, të kryera me dashje të drejtpërdrejtë, ka cënuar në mënyrë të përsëritur të drejtën e zgjedhëve, për të votuar lirisht sipas vullnetit të tyre, e drejtë kjo e mbrojtur posaçërisht nga legjislacioni penal.

Nga ana objektive, kanosja e zgjedhësve, është realizuar nga i pandehuri Hasan Hoti, nëpërmjet dhunës psikologjike të ushtruar ndaj tyre, me qëllimin e posaçëm që ato të votojnë pro kandidatit të Aleancës për Shqipërinë Europiane, (ASHE).

Në të dyja rastet, kanosja ka qenë serioze dhe e vertetë, pasi pas realizimit të kërcënimeve, dy personat e kanosur miratojnë verbalisht urdhrat e personit nën hetim Hasan Hoti, për të votuar pro kandidatit të ASHE-së.

Faktet e dokumentuara në bisedat e përgjuara, përputhen plotësisht me fakte reale të ndodhura në momentin e zhvillimit të ngjarjeve dhe për këtë shkak konsiderohen si prova të plota që vërtetojnë kryerjen e veprës penale nga ky subjekt.

4-Në lidhje me të pandehurin Nuri Meda.

Nga kryerja në tërësi e të gjitha veprimeve hetimore e procedurale dhe në analizë të të gjithë provave e fakteve të grumbulluara, provohet se përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Nuri Meda, ka konsumuar plotësisht elementët e figurës së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi në cilësinë e personit që kryen një detyrë shtetërore, atë të Administratorit të Njësisë Administrative Tomin, bashkia Dibër, nëpërmjet veprimeve të kryera me dashje dhe në kundërshtim me ligjin, të cilat përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës, ka dëmtuar interesa të ligjshëm të shtetasve.

Fakti i përjashtimit të 39 familjeve nga skema e ndihmës ekonomike, vetëm për shkak të bindjeve të politike të ndryshme tyre dhe pa kryer asnjë verifikim të plotësimi ose jo të kriterëve të përfitimit të ndihmës, janë veprime që vijnë në kundërshtim me ligjin nr.9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, dhe gjithashtu përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës nga ana e shtetasit Nuri Meda.

Lidhur me subjektet e veprave penale, shtetasit Robert Aga, Drini Gjeci, Hasan Hoti dhe Nuri Meda, rezulton se ato kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale, janë të

përgjegjshëm përpara ligjit, kanë realizuar me dashje të drejtpërdrejtë veprat penale dhe ndaj tyre nuk egziston asnjë kusht padënueshmërie.

Faktet dhe akuza ndaj të pandehurve, provohen me aktet e procedimit penal nr.385, të vitit 2019 dhe konkretisht: procesverbale për transkriptimin e përgjimeve, dokumente të administruara gjatë verifikimeve të kryera, korespondenca me kompanitë celulare, korespondenca me Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër, bashkinë Dibar dhe Zyrën Arsimore Dibër, dokumentet të administruara me procesverbal këqyrje marrje, etj... .

Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë faktin se hetimet janë kryer të plota dhe provat janë marre në rrugë ligjore, në mbështetje të neneve 24.2, 327.6, germa “b”, 331 dhe 332/dh, pika 1, germa “a” të Kodit të Procedurës Penale,

K Ë R K O J:

-Dërgimin në gjyq të çështjes penale nr.385, të vitit 2019, në ngarkim të të pandehurve:

1-Robert Aga, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal.

2-Drini Gjeci, i akuzuar për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer më shumë se një herë, parashikuar nga nenet 248 dhe 329/3, të Kodit Penal, *(në fuqi në vitin 2016)*.

3-Hasan Hoti, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”, kryer më shumë se një herë, parashikuar nga neni 329/3, i Kodit Penal, *(në fuqi në vitin 2016)*.

4-Nuri Meda, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal.

PROKURORI

URIM BUCI